



Confédération Européenne des Propriétaires Forestiers
Confederation of European Forest Owners
Zentralverband der Europäischen Waldbesitzer

ANALIZA E GJENDJES AKTUALE

Analiza e pylltarisë komunale e private në Shqipëri dhe roli i tyre në procesin e Strategjisë Kombëtare të Pyjeve

STATUS QUO ANALYSIS

Analyses of communal and private forestry in Albania and their role in the National Forest Strategy process

Dr. Thimag LAKO



Published by the

Confederation of European Forest Owners

European Forestry House
Rue du Luxembourg 66
B-1000 Bruxelles

Phone ++32 2 219 0231

Fax ++32 2 219 21 91

office@cepf-eu.org

www.cepf-eu.org

cover photos: Atilla Lengyel

This publication was made available by funding received from the **World BankPROFOR Program**. The sole responsibility of its content lies with the publisher and the authors, the World Bank is not responsible for any use that may be made of the information presented therein.

Falënderime

Ky botim është rezultat i punës së kolegeve të specialiteteve të ndryshme. Për kontributin e dhënë KEPP do të falënderojë në mënyrë të veçantë, përveç autorëve, edhe personat dhe organizatat e mëposhtme

- Agjencinë Holandeze të Zhvillimit (SNV Albania)
- FAO, Zyra Sub-Rajonale për Evropën Qendrore dhe Lindore, Budapest
- Redaktimi i tekstit në anglisht: University of West Hungary, Language Centre, Sopron
- Përkthimi në shqip: Genti Kromidha, Tirana

Acknowledgement

The publication here resulted from the work of colleagues of different specializations. CEPF would especially like to thank apart of the authors for the contributions provided by the following persons and organisations:

- Dutch Development Agency (SNV Macedonia)
- FAO UN, Sub-regional Office for Central and Eastern Europe, Budapest
- English proofreading: University of West Hungary, Language Centre, Sopron
- Albanian translation: Mr Genti Kromidha, Tirana

Qe prej vitit 2003/2004, Konfederate Evropiane e Pronareve të Pyjeve ka zhvilluar një sërë aktivitete që synojnë drejt vendeve të Evropës Qendrore dhe Lindore. Këtu përfshihen shkëmbimet e eksperiencave ndërmjet pronareve të pyjeve dhe organizatave të tyre si dhe aktivitetet e fokusuara në përmirësimin e politikave. Administratat pyjore kombëtare, FAO, IUCN si dhe Komisioni Evropian kanë qenë deri më tani partnerët kryesorë në këtë drejtim. Si rrjedhim i këtij bashkëpunimi janë organizuar disa aktivitete ku janë formuluar dhe diskutuar projekt-idetë, të cilat në disa raste edhe janë zbatuar.

Studimi i paraqitur në këtë botim është hartuar si një analizë e gjendjes aktuale kombëtare (status-quo) në kuadër të programit PROFOR të koordinuar nga KEPP dhe financuar nga Banka Botërore, i cili adreson zhvillimet në politikat sub-rajonale pyjore në Evropën Lindore e Juglindore lidhur me pyjet private. Projekti i ka adresuar këto çështje në të tria vendet e synuara (Shqipëri, Maqedoni, Serbi) brenda kuadrit politik të programeve kombëtare pyjore apo proceseve strategjike përkatëse. Në vendet e Evropës Lindore dhe Juglindore organizimet pyjore jo-shtetërore janë ende jo të zhvilluara dhe kanë nevojë për asistencë në hartimin e politikave dhe ngritjen e kapaciteteve. Pronarët e pyjeve private dhe komunale kanë të vështirë të marrin pjesë aktivisht në përcaktimin e politikave me përmasa kombëtare dhe ndër-sektoriale të tilla si zbatimi i programit kombëtar të pyjeve. Ky fakt vlen edhe për Shqipërinë dhe Maqedoninë, ku tashmë ekzistojnë organizatat e pronarëve të pyjeve në nivel kombëtar (2008).

Në përgjithësi, mund të thuhet se pronësia jo-shtetërore në pyje në vendet e Evropës Lindore e Juglindore përballet me problemin e zakonshëm të kuadrit politik jo të përshtatshëm për të lejuar funksionimin normal të saj. Kjo është pjesërisht trashëgimi i praktikave ligjore të kohës së socializmit, si p.sh., në ish-Jugosllavi ku pronësia private mbi pyjet ishte ligjërish e lejuar por praktikisht tepër e kufizuar dhe nuk ekzistonte asnjë organizatë e pronarëve të pyjeve. Në Shqipëri, çdo lloj pronësie private ishte e ndaluar gjatë regjimit socialist. Me ndryshimet politike të 15 viteve të fundit, shumica e vendeve të Evropës Lindore dhe Juglindore e kanë kaluar fare pak ose nuk e kanë kaluar ende këtë situatë, kështu që pak zhvillime kanë ndodhur në pylltarinë jo-shtetërore. Rrjedhimisht, pronarët e pyjeve janë ende pak të organizuar dhe përfaqësimi i tyre është krahasimisht i ulët në ato pak organizata ekzistuese.

Megjithatë, ky problem i ngjashëm në të gjithë sub-rajonin siguron shanse për adresimin e këtyre çështjeve. Mbi bazën e këtyre konsideratave, KEPP, Banka Botërore dhe partneret kombëtarë në Shqipëri, Maqedoni dhe Serbi hartuan një projekt ide. **Në këtë kuadër, Programet Kombëtare Pyjore apo proceset strategjike do të përfitojnë asistencë veçanërisht për zbatimin e komponentëve të tyre për pylltarinë –jo-shtetërore.** Analizat e kryera në të tre vendet e synuara janë rezultatet e para. Në Maqedoni, p.sh., ky është studimi i parë i këtij lloji që adreson pylltarinë private si temë kryesore. Studimet mbyllin fazën e parë të projektit mbi analizën e gjendjes aktuale (status-quo) dhe do të shërbejnë për aktivitete të mëtejshme në zbatimin e projektit.

Në këtë botim analizat pasohen nga një dokument i veçantë mbi konkluzionet e konferencës sub-rajonale të vendeve të Evropës Lindore dhe Juglindore zhvilluar në Shkup në korrik 2008. Konferenca preku të njëjtat çështje që u diskutuan më sipër dhe studimet mbi gjendjen aktuale u diskutuan në detaje. Konkluzionet e konferencës reflektojnë mbi çështjet kryesore të diskutuara si rëndësia e politikave për pylltarinë private, problemet e menaxhimit dhe kuadri ligjor/politik për pylltarinë private në Evropën Lindore dhe Juglindore.

Dokumentet e paraqitura këtu theksojnë që kjo punë e nisur duhet vazhduar më tej në bashkëpunim me aktoret e interesuar për të përmirësuar situatën për qytetaret e këtyre vendeve që marrin përgjegjësi për pyjet private, *pronarët e pyjeve private*.



Мортен Тхорое
СЕПФ Генерален Секретар

INTRODUCTION

The Confederation of European Forest Owners has been directing targeted activities since 2003/2004 towards Central and Eastern European countries. This includes exchange between forest owners and their organisations and focused work at the policy level. In latter, national forestry administration, FAO UN, IUCN and also the European Commission have been the main partners so far. As a result, several events have been organised along this cooperation and project ideas got developed with linked implementation in some cases.

The study in this publication was developed as a national status quo analysis to the CEPF coordinated and World Bank PROFOR Programme financed project addressing the South East European (SEE) sub-region's forest policy development concerning private forests. The project addressed this issue in all three target countries within the policy frame of the respective national forest programme or strategy processes (Albania, Macedonia, Serbia).

In SEE, non-state forestry organisations are still less developed and are in need for policy assistance and capacity building. Private and community forest owners have difficulties to adequately participate in the policy setting of national and cross-sectoral dimensions such as e.g. national forest programme implementation. This is even the case in Albania and in Macedonia, where national level organisations of forest owners for interest representation already exist (2008).

In general, it can be stated that non-state forest property in the SEE countries faces the common problem of not-enabling policy framework for its proper functioning. This is partly heritage from the socialist times' legal practices of e.g. Ex-Yugoslavia, where private property on forests was legally possible but practically strongly restricted and no organisations of forest owners existed. In Albania even no private property was allowed to exist during the socialist regime. Since the political changes of the last 15 years most of the SEE countries have not or have scarcely overcome this situation and thus little development of the non-state forestry took place. Consequently, forest owners are still hardly organised or their representation is comparatively low in those few existing organisations.

However, this similar problem of the sub-region provides chances to address these issues.

On the basis of these considerations a project idea got developed by CEPF, the World Bank and national partners in Albania, Macedonia and Serbia. ***In this, National Forest Programme or Strategy processes receive assistance specifically in the implementation of their non-state forestry components.*** The analyses in all three target countries are one of the first results. In Macedonia e.g. this is the very first study of its kind addressing private forestry as main topic. The studies closed down the first project phase of the status quo analysis and serve for further follow up in project implementation.

In this publication the analysis will be followed by a separate document on the conclusions of the SEE sub-regional conference held in Skopje in July 2008. The conference tackled the same problematic as described above and the status quo studies were discussed there in detail too. The conference conclusions reflect on the major issues discussed, such as the policy relevance of private forestry, management issues and legal / policy framework for private forestry in SEE.

The documents presented here state however that this work needs to be continued further on, in cooperation with the concerned stakeholders to improve the situation for the citizens of the countries taking responsibility for the private forest land: *the private forest owners.*



Morten Thorøe
CEPF Secretary General



Analiza e gjendjes aktuale

Analiza e pylltarisë komunale e private në Shqipëri dhe roli i tyre në procesin e Strategjisë Kombëtare të Pyjeve

Dr. Thimaq LAKO

Tiranë, Qershor 2008

Përmbajtja

LISTA E SHKURTIMEVE.....	9
LISTA E TABELAVE.....	9
LISTA E FIGURAVE.....	9
1 Vështrim i përgjithshëm mbi pyjet dhe pylltarinë.....	10
1.1 Pozicioni i pylltarisë në ekonominë kombëtare.....	10
1.2 Kushtet ekologjike të pyjeve.....	11
2 Historik i shkurtër mbi kushtet e pronësisë në pyje.....	14
2.1 Hyrje.....	14
2.2 Politikat dhe kuadri ligjor në të kaluarën.....	14
2.2.1 Periudha para pavarësisë së Shqipërisë deri në 1912.....	14
2.2.2 Periudha para 1945.....	15
2.2.3 Periudha 1945-1990.....	16
2.2.4 Periudha pas vitit 1990.....	17
3 Organizimi i pronarëve të pyjeve private dhe komunalë.....	18
3.1 Decentralizimi i menaxhimit të pyjeve shtetërorë.....	18
3.2 Shoqata e Përdoruesve të Pyjeve dhe Kullotave.....	20
3.2.1 Situata politike dhe institucionale.....	20
3.2.2 Transferimi i të drejtave pyjore.....	21
3.2.3 Krijimi i shoqatave të përdoruesve të pyjeve dhe kullotave.....	24
3.3 Organizimi i pronarëve të pyjeve privatë.....	26
4 Zhvillimet më të fundit politike për pyjet komunalë e privatë.....	28
4.1 Orientimet bazë për sektorin e pyjeve.....	28
4.2 Synimet e sektorit të pyjeve.....	28
4.3 Administrimi i pyjeve komunalë.....	29
5 Përmbledhje e procesit kryesor të politikë-bërjes.....	32
5.1 Hyrje.....	32
5.2 Kuadri politik.....	32
5.2.1 Qëllimet e Politikës Pyjore sipas SZSPK.....	34
5.2.2 Synimet e politikës pyjore sipas strategjisë së re të pyjeve (2004).....	34
6 Pylltaria private/Komunale në procesin e PKP/SKP.....	36
6.1 Sfidat e decentralizimit të menaxhimit të pyjeve.....	36
6.2 Sfidat e politikave për pyjet privatë.....	37
7 Përmbledhje.....	40
7.1 Pylltaria komunale.....	39
7.2 Pylltaria private.....	40
8 Literatura.....	41
Konkluzionet e konferencës mbi „Statusin e pyjeve jo shtetërore në Evropën Jug Lindore”.....	42

LISTA E SHKURTIMEVE

PP	Projekti i Pyjeve
IKP	Inventari Kombëtar i Pyjeve
APFDP	Programi për Zhvillimin e Pylltarisë Private në Shqipëri
KEPP	Konfederata Evropiane e Pronarëve të Pyjeve
MPK	Menaxhimi pyjeve të komunitetit
KM	Këshilli i Ministrave
DSHP	Drejtoria e Shërbimit Pyjor
DPPK	Drejtoria e Politikave të Pyjeve dhe Kullotave
DPPK	Drejtoria e Përgjithshme e Pyjeve dhe Kullotave
BE	Bashkimi Evropian
FAO UN	Organizata e Kombeve të Bashkuara për Bujqësinë dhe Ushqimin
SHPPKK	Shoqatat e Përdoruesve të Pyjeve dhe Kullotave
PBB	Produkti i Brendshëm bruto
kg	Kilogramë
NJQV	Njësitë e Qeverisjes Vendore
MMPAU	Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave
MBU	Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit
EPM	Ekipi i planit të menaxhimit
SHKPKKSH	Shoqata Kombëtare e Pyjeve dhe Kullotave Komunale në Shqipëri
OJQ	Organizata Jo-Qeveritare
PZHBN	Projekti për Zhvillimin e Burimeve Natyrore
PPP	Pronarët e Pyjeve Privatë
SEE	Evropa Juglindore
MQP	Menaxhimi i qëndrueshëm i pyjeve
SZHSPK	Strategjia për zhvillimin e sektorit të pyjeve dhe kullotave
SNV	Agjencia Holandeze e Zhvillimit
SME	Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme
USAID	Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar

LISTA E TABELAVE

Tabela 1 Shpërndarja e pyjeve sipas lartësisë mbi nivelin e detit.....	12
Tabela 2 Shpërndarja e pyjeve sipas pjerrësisë së shpateve.....	12
Tabela 3 Sipërfaqja pyjore sipas pronësisë për vitin 1934 dhe periudhen 1940-1945.....	16
Tabela 4 Çështjet kritike dhe rekomandimet për përmirësimin e politikave dhe legjislacionit për pyjet	37

LISTA E FIGURAVE

Fig. 1 Harta e ecurisë së procesit të transferimit të pyjeve komunalë në Shqipëri	19
Figura 2. Shoqatat e Përdoruesve të Pyjeve dhe Kullotave dhe lidhjet e ture me NJQV dhe Shërbimin Pyjor	25

1 Vështrim i përgjithshëm mbi pyjet dhe pylltarinë

1.1 Pozicioni i pylltarisë në ekonominë kombëtare

Pyjet mbulojnë më shumë se 50% të sipërfaqes së vendit. Bujqësia, duke përfshirë pyjet dhe kullotat, është një nga prioritetet e qeverisë, siç deklarohet edhe në programin e Qeverisë Shqiptare për periudhën 2005-2009. Politika e pyjeve, sipas Planit Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit (2007-2012), synon zhvillimin e qëndrueshëm e shumë funksional të pyjeve e kullotave. Sipas këtij plani, do të ruhet dhe mbrohet biodiversiteti, prodhimtaria, aftësia rigjenruese dhe potenciali për të përmbushur funksionet ekologjike, ekonomike dhe shoqërore në nivel lokal, kombëtar dhe global, pa shkaktuar dëmtime në ekosistemet e tjera. Kjo politikë mbështet zgjerimin e zonave të reja pyjore, rehabilitimin e sipërfaqeve të djegura apo të degraduara, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve për sigurimin e ujit të pijshëm në kullota, kontrollin e erozionit nëpërmjet ndërtimit të pritave malore, dhe përmirësimin e menaxhimit të produkteve drusore e jo-drusore të pyllit, çka do të rezultojë në gjenerimin e të ardhurave. [*Plani Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit 2007-2012, fq. 194*]

Bujqësia dhe pylltaria janë dy komponentët më të rëndësishëm në përdorimin e territorit në zonat rurale dhe kanë qenë të lidhura ngushtë me njëra tjetrën përgjatë historisë. Në Shqipëri, fshatarët menaxhojnë njëkohësisht tokën bujqësore dhe pyjet, sipas disa sistemeve tipike agro-pyjore. Brenda këtyre sistemeve agro-pyjore, kulturat bujqësore, drurët dhe bagëtitë menaxhohen në të njëjtën copë toke. Brenda një pellgu ujëmbledhës, fshatarët zakonisht përdorin pjesën e sipërme për pylltari (prodhimet drusore dhe mbrojtje nga erozioni) dhe kullotë, dhe pjesën e poshtme për kultura bujqësore.

Në fund të vitit 2001, mbi 58% e popullsisë së vendit jetonte në zonat rurale (*INSTAT, 2003*). Ka një disproporcion ndërmjet shpërndarjes së popullsisë dhe shpërndarjes së burimeve natyrore, i cili ka një ndikim të madh në përdorimin e këtyre burimeve. Në zonën rurale fushore ku jeton 65.4% e popullsisë ndodhet vetëm 40% e sipërfaqes pyjore, 39% e sipërfaqes kullosore dhe 73% e tokës bujqësore; ndërsa në zonat malore ku jeton 34.5% e popullsisë ndodhen 60% e pyjeve dhe 61% e kullotave, dhe 27% e tokës bujqësore (*Strategji për Bujqësinë në Shqipëri, Raport i Bankës Botërore, 1992*).

Bujqësia dhe pyjet kanë qenë degë të rëndësishme të ekonomisë kombëtare. Në vitin 1992 ky sektor kontribuonte me 42.5% të prodhimit të brendshëm Bruto (PPB). Zhvillimet e kohëve të fundit e kanë ndryshuar strukturën e PPB, ku bujqësia siguron vetëm 20.7% të PPB (2005). Zvogëlimi i kontributit të bujqësisë në PPB nuk do të thotë që është zvogëluar edhe prodhimi bujqësor, përkundrazi, ku prodhim është rritur me 4% çdo vit. Prodhimet pyjore nuk pasqyrohen si zë më vete, por është më se e ditur që bujqësia dhe pyjet mbanë gati gjysmën e popullatës, kryesisht në ferma të vogla familjare..

Në zonat malore pyjet shërbejnë si burim për drutë e zjarrit (që grumbullohen nga fshatarësia), por edhe në zonat urbane drutë përdoren për ngrohje e gatim. Kullotja dhe prodhimi i gjethit për bagëtinë janë gjithashtu të rëndësishme.

Në disa zona, pylltaria është e vetmja mundësi punësimi duke u kthyer në një faktor kryesor në zbutjen e varfërisë dhe migracionit. Përveç druve të zjarrit dhe lëndës drusore, zonat pyjore përdoren për kullotjen e bagëtive dhe sigurimin e gjethit. Kjo kontribuon ndjeshëm në të ardhurat e familjes rurale [*Efektet e projektit të Pyjeve në Zbutjen e Varfërisë, 2002*]. Megjithatë përbën një mundësi të mirë për sigurimin e të ardhurave për popullsinë lokale, mbikullotja ka pasur një efekt negative mbi qëndrueshmërinë e burimeve natyrore në disa zona, dhe nëse ajo vazhdon, mund të pritet një rënie e mëtejshme e të ardhurave për popullsinë e këtyre zonave.

Kohët e fundit, Projekti i Pyjeve (PP) dhe Projekti për Zhvillimin e Burimeve Natyrore (PZBN) financuar nga qeveria Shqiptare dhe Banka Botërore (PP BB) ka reduktuar varfërinë në disa zona. Një studim (*Efektet e PP në zbutjen e varfërisë, 2002*) thekson se të ardhurat nga pyjet (dru zjarri, lëndë drusore, kullotë dhe gjeth për bagëtinë) përbëjnë rreth 20% të të gjithë të ardhurave të familjeve rurale. Për më tepër, të ardhurat e familjes janë rritur me mbi 30% për periudhën 1997-2001, në të cilat rritja e të ardhurave nga pyjet është mbi 43%. Gjithashtu, shumë fshatarë besojnë në një rritje të ndjeshme nga aktivitetet e sipërpërmendura në të ardhmen. Duhet theksuar se roli i pylltarisë në zbutjen e varfërisë nuk njihet plotësisht në nivel kombëtar.

Megjithëse, disa statistika tregojnë se të ardhurat vjetore nga pylltaria shkojnë në 0.83-1.5 Milionë Euro/vit¹, të ardhurat nga materiali drusor janë 50-75% të tyre dhe të ardhurat nga bimët mjekësore dhe produktet e tjera jo-drusore janë 12-30% [*IKP – Plani i Përgjithshëm i zhvillimit të Sektorit të Pyjeve, 2004*]. Vlera e të ardhurave për vitin 2002 ishte rreth 1.44 milion Euro. Shpenzimet qeveritare për një hektar pyll gjatë katër viteve të fundit kanë qenë në një mesatare prej 17 Euro/vit (DPPK, 2003, cit. *IKP – Plani i Përgjithshëm i zhvillimit të Sektorit të Pyjeve*).

Vetëm kjo e dhënë, pa analiza të tjera të detajuara, nuk reflekton rolin që luan pylltaria në të vërtetë. Është e nevojshme të merren parasysh jo vetëm produktet nga sektori pyjor por edhe përfitimet e tjera prej tyre dhe shërbimet mjedisore si një premisë për menaxhimin e qëndrueshëm të tyre në të ardhmen.

1.2 Kushtet ekologjike të pyjeve

Pyjet janë të shpërndara pothuajse në të gjithë vendin, veçanërisht në zonat malore dhe kodrinore. Relieve i Shqipërisë është kryesisht kodrinor-malor, i vendosur kryesisht mbi formacione magmatike dhe sedimentare; me shpate të pjerrët, pjesërisht të paqëndrueshëm, me një lartësi mesatare prej 708 m mbi nivelin e detit (e cila është më se dy herë me e lartë se mesatarja e Evropës). Si vend mesdhetar, Shqipëria përfshihet në zonën me klimë mesdhetare, me një dimër relativisht të shkurtër e shumë të lagësht, dhe një verë të gjatë, të nxehtë e shumë të thatë.

Ndriçimi diellor lëviz nga 2,731 ore në vit në Xarë-Sarandë, në 2,560 orë në Tiranë dhe 2,046 orë në Kukës. Temperatura mesatare është 16.7 °C. Sasia mesatare vjetore e reshjeve është 1,485 mm. Mbi 70% e reshjeve bien gjatë stinës së ftohtë, shpesh të rrëmbyeshme e me karakter torrencial.

Tokat e zonave malore, ku shtrihen shumica e pyjeve dhe kullotave, janë në përgjithësi të cekëta. Në disa raste hasen dhe toka mesatare ose mesatare në të thella. Pjelloria e tokës nuk mund të përcaktohet për thellësinë 20-30 cm të tokave sipërfaqësore në karstet gëlqerore. E rëndësishme është se në të çarat midis blloqeve shkëmbore gëlqerore gjendet toka e mire, duke krijuar toka fiziologjikisht të thellë, ku bimësia pyjore e kullosore e gjen të mundur të vegjetojë. Në përgjithësi, tokat janë shumë të ndjeshme ndaj erozionit sipërfaqësor dhe atij në thellësi, po që se mbulesa vegjetative natyrore e tyre prishet dhe shtresa e holle e tokës ekspozohet ndaj thatësisë në muajt e verës dhe ndaj shirave torrenciale gjatë dimrit.

Shqipëria është një vend i pasur me pyje. Të gjitha pyjet (publike dhe private), apo i ashtuquajturit Fondi Pyjor i Shqipërisë, ndahen në 36 njësi administrative apo rrethe. Shqipëria ka një sipërfaqe pyjore prej 1,498,957 ha (pyje, shkurre, tokë me bimësi pyjore/kullosore – Inventari Kombëtar i Pyjeve, 2004

Sipërfaqja pyjore e Shqipërisë ndahet në:

¹ Kursi i këmbimit 1 Euro = 120 Lekë

Pyjet ²		1,498,957 ha
Trungishte		294,957 ha (19.68%)
Nga të cilat:	-Halorë	84,461 ha
	-Fletorë	210,496 ha
Cungishte		405,016 ha (27.02%)
Shkurre		241,724 ha (16.13%)
Tokë me bimësi pyjore ³		557,260 ha (37.17%).

IKP jep disa të dhëna të vlefshme lidhur me shpërndarjen e pyjeve sipas kushteve natyrore. Lartësia mbi nivelin e detit është një tregues i rëndësishëm. Siç tregohet në tabelën 1, më pak se 14% e sipërfaqeve provë pyjore përfshihen në dy klasat e para të lartësisë, deri 400 m mbi det; më shumë se 40% ndodhen në lartësi mbi 1000m (Tabela 1).

Tabela 1 Shpërndarja e pyjeve sipas lartësisë mbi nivelin e detit

Nr.	Kategoritë e lartësisë	% e sipërfaqes pyjore
1	0-200	4.47
2	201-400	9.32
3	401-600	15.06
4	601-800	13.51
5	801-1000	15.83
6	1001-1200	15.22
7	1201-1400	13.29
8	1401-1600	8.94
9	1601-1800	3.81
10	1801-2000	0.55
11	>2000	...

Burimi: Inventari Kombëtar i Pyjeve (IKP) – Raporti Përfundimtar

Më shumë se 62% e sipërfaqeve provë pyjore gjenden në terrene me pjerrësi më të madhe se 40% (Tabela 2), çka nxjerr në pah problemet me të cilat përballet menaxhimi i pyjeve në Shqipëri, veçanërisht për shfrytëzimin e pyjeve.

Tabela 2 Shpërndarja e pyjeve sipas pjerrësisë së shpateve

Sipërfaqja pyjore	
Pjerrësia	% e sipërfaqes
0-10%	2.61
11-40%	35.24
41-70%	49.75
>70%	12.40

Burimi: Inventari Kombëtar i Pyjeve (IKP) – Raporti Përfundimtar

Me gjithë faktorët kufizues të përmendur me lart, përsëri kushtet për zhvillimin e pyjeve janë të përshtatshme, por prodhimtaria e pyjeve (mesatarisht 1.4 m³ material drusor për hektar) janë mjaft me te ulëta se ato të vendeve të tjera Evropiane. Në anën tjetër, ndryshimet në peizazh nëpërmjet hapjes së tokave të reja bujqësore dhe kullotjes, në rritje paralelisht me shtimin e popullsisë, zjarret, presioni i

² Pylli përkufizohet si një sipërfaqe më e madhe se 0.1 ha e mbuluar jo më pak se 30% me drurë [Ligji nr. 9385 "Për pyjet dhe Shërbimin Pyjor"]

³ Toka me bimësi pyjore përkufizohet si një sipërfaqe e mbuluar në 5-30% me vegjetacion pyjor, e peregjistruar në kadastra të tjera. [Ligji nr. 9385 "Për pyjet dhe Shërbimin Pyjor"]

kullotjes dhe prerjeve për dru zjarri e lende, mund te cilësohen si faktorë të rëndësishëm për degradimin e pyjeve në Shqipëri.

Në Shqipëri numërohen afërsisht 415 njësi përpunim druri, të cilat përpunojnë një sasi prej 360,000 m³ lëndë drusore çdo vit. Konsumi vjetor i druve të zjarrit për familjet fshatare vlerësohet në rreth 4.3 m³/vit. Sasi a e dokumentuar e konsumit të druve të zjarrit për familjet fshatare është 1.6 milion m³ dru zjarri në vit. [DRN, *Analiza e tregjeve dhe marketingu i produkteve pyjore, Korrik, 2003*].

Gjithashtu, Shqipëria është e njohur edhe për cilësinë e produkteve pyjore jo drusore si bimët mjekësore, eterovajore e tanifere, etj. Çdo vit eksportohen mesatarisht 7,400 ton produkte me një vlerë prej 10 milion USD [JKP – *Plani i Përgjithshëm i zhvillimit të Sektorit të Pyjeve, 2004*].

Gjatë 60 viteve të fundit (periudha komuniste dhe e tranzicionit) pylltaria Shqiptare ka vuajtur ndryshime thelbësore. Sipërfaqja pyjore është reduktuar me rreth 300,000 ha dhe shumica e pyjeve janë degraduar nga shfrytëzimi pa kriter dhe mbikullotja [MBU, *Strategjia e gjelbër për zhvillimin e bujqësisë, 1998*]. Degradimi i pyjeve dhe erozioni janë problemet kryesore në menaxhimin e burimeve natyrore.

2 Historik i shkurtër mbi kushtet e pronësisë në pyje

2.1 Hyrje

Pronësia private mbi tokën bujqësore, pemët frutore, ullishtat, pyjet, kullotat dhe livadhet ka qenë njohur në Shqipëri që në fillim të viteve 1900. Gjithashtu ka ekzistuar prona e përbashkët e fshatit apo fisit. Ka pasur ligje dhe zakone të rrepta për ruajtjen e pronës, të cilat zbatoheshin nga shoqëria e atëhershme si një ligj i pashkruar. Në veçanti, “Kanuni i maleve” dhe “Ligja e pyjeve dhe kullotave” e vitit 1923, përmbanin dënime të rënda për shkeljen e ligjeve të pronësisë. Megjithatë, në vitin 1945, regjimi komunist filloi shtetëzimin e pyjeve dhe gjatë periudhës 1950-1960 të gjitha pyjet u bënë pronë shtetërore.

Prona private, përfshirë edhe pyjet, u rinjoh ligjërisht pas ndryshimeve social ekonomike të viteve 1990. Sipas ligjeve aktuale ish pyjet private mund tu kthehen pronarëve të tyre. Megjithatë, procesi i kthimit të pronave ka qenë tepër i ngadaltë si pasojë e problemeve procedurale dhe mungesës në përgjithësi të njohurive mbi ligjin.

Kjo situatë, shoqëruar edhe me idenë e krijuar në mendjet e shumë njerëzve gjatë regjimit komunist se “prona shtetërore është pronë e askujt”, ka çuar në një degradim të rëndë të shumë sipërfaqeve pyjore, kryesisht ato pranë fshatrave.

Gjatë periudhës së tranzicionit, objektivi kryesor i politikës pyjore përsa i përket zhvillimit të pylltarisë private ka qenë rikthimi i pyjeve private sipas pronësisë në vitin 1945.

Njohja e pronësisë dhe rikthimi i pronave të marra gjatë viteve 1945-1990 është përcaktuar edhe në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, miratuar në 21 Tetor 1998 (nenet 41 dhe 181). Neni 181 përcakton objektivin e parlamentit për të amenduar dhe plotësuar brenda 2-3 vjetëve kuadrin ligjor lidhur me çështjet e zënies apo konfiskimit të tokave, të bëra para miratimit të Kushtetutës. Strategjitet e DPPK për Zhvillimin e Sektorit të Pyjeve dhe Kullotave në Shqipëri (1999-2004) e kanë pranuar “Njohjen e të drejtave të pronësisë private dhe privatizimin e pronës publike” (faqe 45).

2.2 Politikat dhe kuadri ligjor në të kaluarën

2.2.1 Periudha para pavarësisë së Shqipërisë deri në 1912

Periudha e parë, para pavarësisë së Shqipërisë deri më 1923, i referohet një situatë shumë të vështirë ku fuqi të ndryshme dominonin jetën në Shqipëri me ligjet e tyre të ndërthurura me tradita të lashta. Informacionet më të hershme mbi ekzistencën e pyjeve private të administruara nga fshatrat gjenden në “Historinë e Ballkanit”. Nën Perandorinë Bizantine në shekullin e VII, filloi të zhvillohej një fshatarësi e lirë. Statusi i saj shprehej në ligjin bujqësor (*Nomos Georgikos*) të Justinianit II (705-711). Fshatarët konsideroheshin si pronarë që kishin të drejtë të trashëgonin pasurinë e tyre, e cila përfshinte tokën bujqësore, vreshtat dhe pemëtoret. Fshatarët formuan një komunitet i cili zotëronte pyjet kullotat dhe terrenet e egra. Në Perandorinë Bizantine, ky komunitet njihej si njësi administrative dhe fiskale. Në periudhat e mëvonshme, statusi ligjor i komuniteteve fshatare gjatë Perandorisë Bizantine nuk është revokuar kurrë.

Dokumenti kryesor i kësaj epoke, që përmbledh rregullat e para për administrimin e pyjeve private është Kanuni i Maleve (*Kanuni i Lek Dukagjinit*). Ligji i pyjeve të Perandorisë Osmane, miratuar në vitin 1870, e konsideronte të gjithë sipërfaqen pyjore si pronë shtetërore por ky ligj kishte ndikim të pakët në Shqipëri, veçanërisht në krahinat autonome në veri të Shqipërisë. Kështu, praktikat e administrimit të

pyjeve private deri në shpalljen e pavarësisë së Shqipërisë bazoheshin kryesisht në “Kanunin e Lekë Dukagjinit” [Kanuni i Lekë Dukagjinit, 1989]

Kanuni i Lekë Dukagjinit thotë se “Shkaf â'shpí, si qet tym, do të két pronet e veta” (Kreu. 12, para. 213); “Plangu i shpis ká oborr e kopshtë, ká vêshtë e arë, ká livadh e xâna, ká udhë e shteg, ká kufij si në mal, si në vrrí, si në fushë” (para 214). Paragrafi 216 përmend: “Ara, vêshta, kopshti e livadhi, xâna, prozhme e zabele, jânë të dame me kufij”.

Kodi thotë se “Kujria âsht vendi, si e ká perbashkarisht një katund a një flamur per kullosë, per landë, per drû, per gjojë e per tjera nevojë”. “Kujrija nuk dahet; por, sá shpí a tyme të janë në katund, kan tager në kujrí të katundit, e sá tyme të janë në flamur, kan tager në kujrí të Flamurit” (par. 232, 233). Kufijtë e pronavë si private sit ë përbashkëta respektoheshin nga të gjithë. “Kufíni i ngulun nje herë, nuk luhet mâ” (Kreu. 13, para. 242), dhe “Eshtnat e vorrit e guri i kufinit faqe Kanunit jânë paraz. Me lujt kufinin âsht një si me lujt me eshtnat e të dekunve.” (par 243). Kanuni parashikonte dënime të rënda për ata që shkelnin rregullat. Për shembull, “Njiqind herë në ditë në hiftë tufa e huaj në mal të huej, aq berre do të lajë i zoti i tufës” (para. 287). Lidhur me dëmtimet e shkaktuara nga dhitë, kanuni thotë “Nji dhí thán një vrrí” (para.745).

Gjatë kohës së Kanunit, pyjet dhe kullotat plotësonin nevojat e fshatarëve dhe kishte pak ose aspak probleme me degradimin e burimeve natyrore.

2.2.2 Periudha para 1945

Periudha e dytë, deri në 1945, i referohet kohës kur Qeveria Shqiptare ndërmori përpjekje serioze për konsolidimin e shtetit ligjor. Parlamenti Shqiptar miratoi ligjin e parë për pyjet në vitin 1923. Ligjet dhe rregulloret e nxjerra në këtë periudhë hodhën themelet e administrimit të pyjeve private dhe pylltarisë në përgjithësi. Ligji i parë shqiptar për pyjet dhe kullotat (1923) është një ligj gjithëpërfshirës që synonte të integronte traditat lokale me eksperiencat më të mira të vendeve të tjera dhe konsiderohet si ligji i parë i shtetit Shqiptar në këtë fushë. Ligji njihte pyjet dhe kullotat private (neni 10) dhe u njihte pronarëve të drejtën e zotërimit dhe përfitimit (Neni 9). Si pasojë e ligjit të Sherihatit të Perandorisë Osmane, sipërfaqja e pyjeve private në Shqipëri ishte e vogël dhe nuk i kalonte 5% të sipërfaqes totale të pyjeve 63,000 ha).

Njiheshin tre kategori të pronësisë mbi pyjet: (i) private; (ii) komunale (një njësi administrative e përbërë nga disa fshatra); dhe (iii) shtetërore (neni 10).

Pronësia mbi tokën njihej në bazë të dokumenteve zyrtare dhe me kufij të përcaktuar qartë; ku vendoseshin shenja të dukshme kufijsh kur ishte e nevojshme (nene 6, 7, 15). Ishte e ndaluar konvertimi i pyjeve në tokë bujqësore nëse nuk kishte përfitime të konsiderueshme. Pyjet private ruheshin nga roje të caktuara nga pronari apo nga roje shtetërore të paguara nga pronari (neni 26). Askush nuk mund të hyjë në pyllin privat pa leje; leje kërkohet edhe për grumbullimin e degëve, lëgushës apo dheut, apo për të kullotur bagëtitë (neni 28, 29). Krasitja, prerja e filizave dhe heqja e lëvores së drurëve për ushqim për bagëtinë ishte e ndaluar. Krasitja e dushqeve dhe drurëve të tjerë të vjetër të shpërndarë nëpër kullotë lejohej vetëm me lejen e Shërbimit Pyjor (neni 34, 35). Lejohej grumbullimi i prodhimeve të dyta pyjore, edhe pse për këto lloj aktiviteteve kërkohesh leje e veçantë (neni 36, 37). Kullotja e kafshëve jashtë zonave të autorizuara ishte e ndaluar. Kullotja në pyjet e shfrytëzuar ndalohej për 10 vjet, për të siguruar ripërtëritjen e tyre (neni 39, 40).

Tabela 3 Sipërfaqja pyjore sipas pronësisë për vitin 1934 dhe periudhën 1940-1945

Pronësia	1934 (ha)	1940-1945 (ha)
Pyje private	63,000	63,000
Pyje shtetërorë	927,000	1,050,000
Pyje komunalë	(nuk ka të dhëna)	16,000
Tokë me bimësi pyjore ⁴	400,000	250,000
Sipërfaqja e përgjithshme e pyjeve	1,390,000	1,379,000

Burimi: Muharremi V., 1998

Ishte detyra e fshatit të merrte masa për shuarjen e zjarrit në pyje, përfshirë edhe zonat private (neni 43, 44), dhe të rriste dendësinë e pyjeve të degraduara duke mbjellë fidanë të rinj. Ligji përcaktoi kritere teknike për prerjen e drurëve të moçëm, ripërtëritjen dhe mirëmbajtjen e pyjeve (neni 50-57). Ishte e ndaluar mbulimi i shtëpive me petavra druri si mundësi për keqpërdorimin e pyllit (neni 63). Sasia e lëndës drusore që duhej prerë dhe vendi për grumbullimin e druve të zjarrit dhe prodhimit të qymyrit duhet të caktohej nga një pylltar (neni 74).

Një taksë prej 7% mbi çmimin e tregut aplikohet për drurët e prerë në pyjet private (neni 75). Lënda drusore e përdorur për ndërtimin e shtëpisë përjashtohet nga taksat. Kur nga pyjet privatë nxirreshin dru zjarri me shumicë dhe përdorshin nga industria, kjo industri duhet të paguante një taksë pylli, që përcaktohet nga bashkia (neni 77). Fshatarët që tregtonin dru zjarri apo qymyr për nevoja familjare lejoheshin të përgatisnin 5,000-10,000 kg qymyr pa tender (neni 94). Taksat nga prodhimet drusore dhe jo-drusore të prodhuara nga pyjet privatë i paguheshin shtetit përpara nxjerrjes nga pylli (neni 107). Kishte udhëzime për kontrollin dhe matjen e lëndës së shfrytëzuar si dhe për transportimin e saj. Nëse dikush priste drurë pa leje në një pyll privat, ai ishte i detyruar ta ripyllëzonte atë, përveç pagesës së gjobave (neni 160). Gjithashtu, kishte gjoba dhe dënime për ndezjen e zjarreve, kullotjen dhe dëmtimet e tjera të pyjeve (neni 162-172).

Ligji i datës 23 prill 1934 ishte një shtesë e ligjit të mësipërm të pyjeve dhe kullosave dhe përjashtonte disa produkte pyjore –p.sh., lëndën e shfrytëzuar me shumicë në pyjet privatë dhe të përdorur nga industria, dhe drutë e zjarrit dhe qymyrin për eksport – nga taksat dhe çmimet (neni 1-3).

2.2.3 Periudha 1945-1990

Periudha e tretë, 1945-1992, karakterizohet nga një shpronësim ekstrem i pyjeve private dhe zhdukja e pronës private nga shteti. Termi “private” në legjislacionin e pyjeve gjatë kësaj periudhe nuk ekzistonte. Shtetëzimi i pyjeve u krye në bazë të ligjit të datës 29 Gusht 1945. Disa sipërfaqe të vogla pyjesh privatë iu lanë pronarëve përkatës edhe për një periudhë të shkurtër kohe, por pronësia private mbi pyjet u zhduk plotësisht në vitin 1966, kur kooperativat bujqësore u shtrinë në të gjithë vendin. Të gjitha tokat, përfshirë pyjet, u deklaruan pronë shtetërore nga kushtetuta e vitit 1976.

Politika e shtetit komunist për hapjen e tokave bujqësore edhe në zonat malore çoi në shkatërrimin e shumë pyjeve me vlerë. Duke qenë të papërshtatshme për kulturat bujqësore, shumica e tyre u braktisën pas vetëm një apo dy vjetësh. Shumë prej pyjeve private u shkatërruan si pasojë e kësaj politike, kryesisht pranë qendrave të banuara. Aktualisht, këto toka janë nga më të degraduarat si pasojë e mbi shfrytëzimit dhe mbikullotjes kombinuar me zjarret e shpeshta. [MOAF, 1998]

⁴Toka pyjore përcaktohet si sipërfaqe e mbuluar me drurë e shkurre mbulesa e të cilës shkon nga 5-30%.

Gjatë kësaj kohe janë hartuar një sërë ligjesh dhe rregulloresh për pyjet të cilat janë zbatuar vetëm pjesërisht. Përgjithësisht, njerëzit nuk tregojnë ndonjë interes të madh në ruajtjen e pasurisë shtetërore krahasuar me ruajtjen e pasurive të tyre apo të fshatit të tyre [Muharremi V., 1998].

2.2.4 Periudha pas vitit 1990

Periudha e katërt, pas vitit 1990, karakterizohet nga një periudhë tranzicioni drejt ekonomisë së tregut. Ligji Nr. 7623, i datës 13 tetor 1992 “Për pyjet dhe Policinë e Shërbimit Pyjor” i njëjti pyjet private (neni 4) si pyje të krijuar mbi toka private nëpërmjet pyllëzimeve dhe përmend që administrimi, zhvillimi, ruajtja dhe menaxhimi i pyjeve shtetërore, komunalë e privatë do të bëhet sipas dispozitave të këtij ligji (neni 6). Gjithashtu, ai thekson që shfrytëzimi i pyjeve private nuk duhet të rrezikojë mbrojtjen e tokës dhe elementeve klimatike (neni 23), dhe se të gjithë pyjet, pavarësisht pronësisë, duhet të menaxhohen dhe mbrohen nga zjarret dhe dëmtuesit e tjerë (neni 36). Megjithatë, ligji nuk përmend asgjë tjetër për pyjet private që rezultojnë nga procesi i kthimit të pronave ish pronarëve.

Sipas ligjit nr. 7699, datë 21 Prill 1993 “Për kompensimin në vlerë ose në natyrë të ish pronarëve të tokës bujqësore, kullotave, livadheve, pyjeve dhe tokave pyjore” dhe amendamenteve të mëvonshme të tij, ish pronarët (dhe trashëgimtarët e tyre) me dokumente zyrtare mund të kërkojnë njohjen e pronësisë së këtyre tokave sipas gjendjes kadastrale të datës 1 Gusht 1991. data 1 Gusht 1991 shënon fillimin e reformës së tokës bazuar në ligjin nr. 7501 “Për tokën”. Të gjitha kullotat dhe livadhet e pretenduara nga pronarët privatë do të kthehen pa kufizime ndërsa sipërfaqja pyjore jo. Sipërfaqja pyjore që i kthehet ish pronarëve është kufizuar në maksimumi 100 ha edhe nëse sipërfaqja e zotëruar ka qenë më e madhe. Nëse pyjet, kullotat, livadhet apo tokat pyjore janë brenda zonave turistike, ato mbeten pronë shtetërore dhe pronarët do të kompensohen në vlerë ose në natyrë në këto zona (neni 7/1 dhe 7/2).

Mbi bazën e këtyre ligjeve janë hartuar edhe një numër aktesh të tjera nënligjore, si:

- VKM nr. 438, i datës 17 Qershor, 1996 “Për disa shtesa në VKM nr. 560, datë 16 Tetor, 1995”, “Për masat për zbatimin e ligjit nr 7699, datë 21 Prill, 1993 “për kompensimin në vlerë të ish pronarëve të tokës bujqësore”.
- Udhëzim i Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit dhe Komitetit Shtetëror për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave, nr. 6, datë 27 Qershor 1996 “Për zbatimin e VKM nr. 560, datë 16 Tetor, 1995”, “Për masat për zbatimin e ligjit nr 7699, datë 21 Prill, 1993 “për kompensimin në vlerë të ish pronarëve të tokës bujqësore”.
- VKM nr. 66 datë 11 Shkurt, 1997 “Për disa ndryshime në VKM nr. 560, datë 16 Tetor, 1995”, “Për masat për zbatimin e ligjit nr 7699, datë 21 Prill, 1993 “për kompensimin në vlerë të ish pronarëve të tokës bujqësore” (shih 3.3)

3 Organizimi i pronarëve të pyjeve private dhe komunale

3.1 Decentralizimi i menaxhimit të pyjeve shtetërorë

Në fillim të viteve 1990 Shqipëria filloi procesin e tranzicionit nga një sistem i centralizuar në një sistem të ekonomisë së tregut. Burimet pyjore u vunë nën një presion të madh njerëzor (dru zjarri, kullotë) çka solli degradimin e tyre, veçanërisht të pyjeve të lartë apo pyjeve pranë qendrave të banuara. Investimet në menaxhimin e pyjeve ranë ndjeshëm që nga mesi i viteve 1980. Qeveria ndërmori një sërë reformash që u fokusuan më tepër në procesin e decentralizimit dhe privatizimit të ekonomisë. Përgatitja dhe zbatimi i ligjeve ishte sfida kryesore që në fillim të periudhës së tranzicionit.

Transferimi i pyjeve në përdorim të Njësive të Qeverisjes Vendore-NQV (komuna/fshatra) ishte një nga reformat më të rëndësishme në sektorin e pyjeve. Filozofia pas procesit të transferimit të pyjeve shtetërorë komunave është pikërisht njohja e nevojave të popullatave lokale për produkte pyjore dhe shërbime, dhe e të drejtës së tyre për ti përdorur ato. Transferimi bëhet në komunë e cila më pas harton marrëveshje me fshatrat apo përdoruesit individualë (familjarë).

Procesi i transferimit filloi në vitin 1996, kur Qeveria Shqiptare dhe Banka Botërore nënshkruan marrëveshjen për zbatimin e Projektit të Pyjeve. Menaxhimi i pyjeve komunale (MPK) nga komunitetet rurale ishte një nga komponentët kryesorë të këtij projekti. Parimet kryesore që u zbatuan për menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve komunale, ishin si më poshtë:

- Përqendrohu tek njerëzit, jo tek drurët;
- Menaxhimi pyjeve bëhet nga vendasit jo nga njerëz jashtë komunitetit;
- Pjesëmarrje aktive e anëtarëve të komunitetit gjatë procesit të përgatitjes dhe zbatimit të planit të menaxhimit.
- Transfero kompetencat dhe përgjegjësitë te komuniteti;
- Trajno dhe ngri kapacitetet e komunitetit mbi menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve, etj.

Zbatimi i MPK u bazua në menaxhimin me pjesëmarrje të pyjeve komunale nga komunitetet rurale të organizuar në Shoqatat e Përdoruesve të Pyllit dhe Komisionet e Pyjeve në bazë fshati dhe komune, si dhe nëpërmjet hartimit të një metodologjie për sigurimin e pjesëmarrjes së fshatarëve dhe zgjidhjen e konflikteve në nivel lokal. Ecuria e procesit të transferimit të pyjeve shtetërorë Njësive të Qeverisjes Vendore-NQV (komuna/fshatra) dhe përgatitjes së planeve të menaxhimit për pyjet komunale, sipas Projektit për Zhvillimin e Burimeve Natyrore, tregohen në figurën 1.




Fig. 1 Harta e ecurisë së procesit të transferimit të pyjeve komunalë në Shqipëri

Treguesit kryesorë të arritjeve në menaxhimin e pyjeve komunalë në Shqipëri gjatë periudhë 1996-2003 janë:

- 138 komuna me 1,290 fshatra ku ka përfunduar procesi i transferimit;
- 724 mijë banorë të fshatrave të përfshirë në MPK;
- 356,000 Ha pyje shtetërorë transferuar në përdorim NQV.

Transferimi i pyjeve sipas filozofisë së MPK nuk është thjesht një kthim i pyjeve por kthim i përgjegjësive për menaxhimin e pyjeve njerëzve që jetojnë pranë tyre. Procesi është i gjatë dhe jo një

transferim i thjeshtë i sipërfaqes pyjore “në përdorim” komunave dhe fshatrave. Ai është procesi i transferimit të përgjegjësi shtetërore për menaxhimin e pyjeve pushtetit vendor. Ky proces hedh themelet për fillimin e menaxhimit të pyjeve nëpërmjet hartimit dhe zbatimit të planeve të menaxhimit nga pushteti vendor. Kjo nxit një menaxhim të qëndrueshëm e të decentralizuar të burimeve natyrore me pjesëmarrjen e komunitetit. Prandaj, MPK nuk është thjesht një metodë për menaxhimin e pyjeve komunalë, por është gjithashtu pjesë e procesit të fuqizimit dhe ngritjes së kapaciteteve të pushtetit vendor.

Zhvillime të reja kanë ndodhur që nga shtatori 2007. Qeveria Shqiptare vendosi të shpejtojë procesin e transferimit të pronave publike Njësive të Qeverisjes Vendore (NQV), veçanërisht për pyjet shtetërore. Ky proces është pothuajse i përfunduar formalisht pa pjesëmarrjen e komuniteteve lokale. Pyjet shtetërore mund të transferohen në pronësi apo në përdorim sipas kërkesave të NQV.

3.2 Shoqata e Përdoruesve të Pyjeve dhe Kullotave

3.2.1 Situata politike dhe institucionale

Pyjet komunalë kanë disa veçori dalluese në menaxhimin e tyre. Ky lloj menaxhimi përfshin shumë aktorë me përgjegjësi dhe detyra specifike. Në Shqipëri, rolin kryesor e luajnë Shoqatat të Përdoruesve të Pyjeve dhe Kullotave (SHPPK). Aktorë të tjerë kryesorë janë Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave (MMPAU), Drejtoria e Politikave të Pyjeve dhe Kullotave (DPPK) me administratën e saj lokale, Drejtoritë e Shërbimit Pyjor (DSHP) në rrethe, dhe komunitatet dhe fshatrat.

Procesi ka pasur një mbështetje të kënaqshme politike pasi në Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit, Strategjinë për Mbrojtjen e Mjedisit, Strategjinë e Gjelbër dhe Strategjinë për Zhvillimin e Pyjeve, transferimi i pyjeve komunalë, me të drejta të plota përdorimi apo pronësie, njësive të qeverisjes vendore dhe komuniteteve lokale është përcaktuar qartë si objektivi parësor në decentralizimin e qeverisjes dhe menaxhimit të burimeve natyrore në Shqipëri. Në këtë drejtim, një rol të rëndësishëm ka luajtur Projekti i Pyjeve (PP) financuar nga Banka Botërore. Efektet pozitive të këtij procesi mund të vërehen në një periudhë të shkurtër pasi komunitetet e përfshira në këtë proces kanë filluar ta shohin veten si aktorë kryesorë dhe kanë dhënë një kontribut të konsiderueshëm për mbrojtjen dhe rehabilitimin e pyjeve.

Organizata të tjera ndërkombëtare, duke ditur që pjesëmarrja dhe organizimi i komuniteteve në shoqata është çelësi i suksesit, e kanë fokusuar punën e tyre në këtë drejtim duke dhënë një kontribut të ndjeshëm në fuqizimin e këtyre shoqatave. Procesi i transferimit u ndërpre me mbarimin e Projektit të Pyjeve në vitin 2004. Megjithatë, bazuar në rezultatet pozitive të projektit të parë, Qeveria Shqiptare dhe Banka Botërore nënshkruan një marrëveshje për një projekt të dytë, fokusuar kryesisht në pyjet komunal, i cili do të zgjasë nga Tetori 2005 deri në Tetor 2010. Projekti i ri për Zhvillimin e Burimeve Natyrore (PZHBN) synon forcimin e menaxhimit të pyjeve me pjesëmarrjen e komunitetit si në komunitat ku procesi ka përfunduar ashtu edhe në komunitat e mbetura.

Situatë e re dhe përvoja e fituar në menaxhimin e pyjeve komunale kërkonte që institucionet shtetërore të përmirësonin kuadrin ligjor. Në këtë kuadër, u përgatitën dhe u miratuan ligji i ri i pyjeve, ligji për transferimin e pronave publike njësive të qeverisjes vendore, si dhe një sërë aktesh të tjera nënligjore. Kuadri i ri ligjor intensifikon procesin e decentralizimit në menaxhimin e burimeve natyrore dhe eliminon një sërë kufizimesh të parashikuara në ligjet e mëparshme, si për shembull, kufizimi i sipërfaqes së transferueshme në 0.4 ha për familje apo kufizimi i kohës së transferimit në 10 vjet.

Përveç këtyre zhvillimeve pozitive, procesi i transferimit dhe menaxhimit të pyjeve komunale me të drejta të plota përdorimi nga komunitetet lokale ka ende shumë mangësi, veçanërisht përsa i përket ndarjes së përgjegjësive e përfitimeve dhe investimeve në pyjet komunalë.

Projekti i ri i Bankës Botërore (PZhBN) përveç investimeve direkt në përmirësimin e pyjeve parashikon edhe një gamë të gjerë aktivitetesh që mbështesin intensifikimin e reformës politike, si dhe përmirësimin e procesit për të drejtat e përdorimit dhe pronësisë në pyjet komunalë të individëve lokalë dhe veçanërisht ShPPK.

3.2.2 Transferimi i të drejtave pyjore

Në vitin 2008 transferimi i pyjeve ka përfunduar pothuajse në të gjitha komunat e Shqipërisë. Një problem kyç është ndarja e përgjegjësive dhe bashkëpunimi midis Drejtorive të Shërbimit Pyjor, pushtetit vendor dhe komuniteteve.

Fillimisht, metodologjia e procesit të transferimit ishte përshkruar në rregulloren e Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit, nr. 308, datë 26 Janar 1996. Ajo ka dy pjesë kryesore:

- Organizimi i një strukture zbatuese (Komisionet e Pyjeve në Fshatra, Shoqata e Përdoruesve të Pyjeve, DSHP dhe komunat),
- Hartimi dhe zbatimi i planeve të menaxhimit për pyjet komunalë.

Sipas ndarjes administrative të Shqipërisë, fshati është njësi administrative më e vogël dhe është pjesë e komunës. Fshati ka territoret dhe kufijtë e tij tradicionalë. Çdo fshat ka një kryetar të zgjedhur. Duke marrë parasysh rolin thelbësor të pjesëmarrjes së komuniteteve, veçanërisht gjatë përgatitjes dhe zbatimit të planeve të menaxhimit, Këshilli i Ministrave ka nxjerrë një vendim që komunat duhet të mbështesin krijimin dhe funksionimin e ShPPK. VKM nr. 396, datë 21 Qershor 2006 "Për kriteret e transferimit dhe përdorimit të pyjeve nga njësitë e qeverisjes vendore" thekson se komunat duhet të identifikojnë zonat pyjore që do të transferohen sipas përdoruesve të regjistruar në Zyrën Rajonale të Regjistrimit. Ngritja e komisionit të pyjeve të fshatit është bazuar në rregulloren 308 dhe traditat ekzistuese. Komisioni i fshatit krijon shoqatën e përdoruesve të pyjeve dhe kullotave. Meqenëse, organizimi i komuniteteve lokale është në nivel fshati menaxhimi i pyjeve mund të fillojë me lehtësi. Komisionet e fshatrave marrin vendime për përcaktimin e kufijve, identifikimin e përdoruesve dhe përcaktimin e përdorimeve, si dhe zbatimin e planit të mbrojtjes dhe përmirësimit të pyjeve komunalë. Ato kanë gjithashtu, një rol thelbësor në menaxhimin dhe zgjidhjen e konflikteve.

Në Projektin e Pyjeve të bankës Botërore të përfunduar në 2004, pjesëmarrja e komuniteteve lokale në përgatitjen e planeve të menaxhimit u vlerësua si problemi kryesor i procesit. Prandaj, projekti i ri PZhBN pritet ti kushtojë një vëmendje të veçantë rritjes së përvojës dhe njohurive të individëve të ndryshëm në këtë proces. Në kuadër të këtij projekti, janë rishikuar dhe po rishikohen të gjitha planet e menaxhimit ekzistuese dhe po ngrihen komisionet e fshatrave si aktorë kyç për identifikimin dhe ligjërimin e përdoruesve. Hapat e procesit për transferimin e pyjeve komunalë dhe përgatitjen e planeve të menaxhimit tregohen në tabelën 4.

Tabela 4: Hapat e procesit të transferimit dhe menaxhimit të pyjeve komunalë

Hapi	Kush përfshihet	Cili është roli i tyre	Probleme kyçe që do të adresohen dhe detaje të tjera	Burimet e nevojshme
1 Procesi i ndërgjegjësimit në fshatra, në bazë komune	Kryetari i Këshillit të Komunës kryetari i fshatit EPM (5) , DSHP	Sigurimi i informacioneve mbi transferimin e pyjeve shtetërorë në përdorim të fshatit	<ul style="list-style-type: none"> • Kërkesë zyrtare e komunës për transferimin e pyjeve në Zyrën e Regjistrimit dhe Transferimit të Pronave Publike dhe DSHP; • Marrëveshje midis komunës dhe DSHP për fillimin e procesit; • Caktimi i pylltarit komunal; • Përzgjedhja e Ekipit të Planit të Menaxhimit (EPM) në përputhje me udhëzimet e Menaxhimit të Pyjeve me Pjesëmarrje; • Programi i ndërgjegjësimit realizohet nga EPM • Ngritja e Komisioneve të Pyjeve në fshat; • Krijimi i SHPPKK (të gjitha komisionet e fshatrave zgjedhin bordin e SHPPKK). • Cakto takimet në kohën kur shumica e komunitetit mund të marrë pjesë, p.sh., jo gjatë orarit të punës apo përgatitjes së ushqimit. • Fshatarët duhet të udhëzohen që të përfshijnë njerëzit e varfër dhe gratë në takime dhe vendim-marrje. 	<p>Kontraktimi i Ekipit të Planit të Menaxhimit nga komuna në përputhje me udhëzimet e Menaxhimit të Pyjeve me Pjesëmarrje.</p> <p>Duhet hartuar një udhëzues i thjeshtë për përgatitjen e planit të menaxhimit.</p>
2 Fillo procesin e transferimit dhe përgatitjen e planit të Menaxhimit për Pyjet Komunalë (MPK)	Kryetari i Këshillit të Komunës Komisionet e fshatrave, SHPPKK (Kryetari i SHPPKK dhe pylltari komunal), EPM , DSHP	hartimi i planit të MPK në nivel fshati, përcaktimi i kufijve, përdorimeve dhe përdoruesve	<ul style="list-style-type: none"> • Identifikimi i kufijve të fshatit; • Përfshinë Komisionin e fshatit fshatarë të marginalizuar që jetojnë në periferi të fshatit. • Identifikimi i përdoruesit dhe përdorimet në bazë fshati, problemet e tyre, prioritetet dhe mundësitë; • Përshkrimi i parcelave sipas menaxhimit të përdoruesit; • Përcaktimi i objektivave kryesore të MPK, problemeve kryesore dhe zgjidhjeve; • Vendimi i fshatit për përdorimin e pyllit të përbashkët. 	
3 Përgatitja e hartës së fshatit bazuar përdorimet dhe përdoruesit e identifikuar në hapin 2	Komisionet e fshatrave, SHPPKK dhe pylltari komunal, EPM , DSHP kadastra	Arritja e marrëveshjes midis përdoruesve	<ul style="list-style-type: none"> • Publikimi i hartave që tregojnë kufijtë e fshatit, kufijtë e parcelave dhe emrat e personave që do të përdorin ato parcela; • Vendosja e shenjave të kufirit • Individët dhe familjet e varfra jetojnë në të cilëve rrezikohet nga ndalimi i aksesit do të përjashtohen nga kufizimi i aksesit në këto zona. 	
4 Hartimi i planit të MPK në	Komisionet e	përfundimi i planeve të	<ul style="list-style-type: none"> • Miratimi i planit të MPK të fshatit nga Komisioni i fshatit; 	

(5) MPT = Management Planning Team = Head of Management Section-DFS, CFM Coordinator-DFS, Private Consultant selected for the management plan preparation.

Hapi	Kush përfshihet	Cili është roli i tyre	Probleme kyçe që do të adresohen dhe detaje të tjera	Burimet e nevojshme
nivel fshati dhe komune	fshatrave, Këshilli i Komunës SHPPKK dhe pylltari komunal, EPM , DSHP	MPK	<ul style="list-style-type: none"> Miratimi i planit të MPK nga Këshilli i Komunës; Miratimi i planit të MPK nga DSHP; Vëmendje e veçantë i duhet kushtuar sigurimit të mundësive për punë të paguar për gratë. 	
5 Transferimi ligjor i të drejtave të përdorimit	Kryetari i Këshillit të Komunës DPPK	Përfundimi procesit të transferimit	<ul style="list-style-type: none"> Përgatitja e dokumenteve ligjore midis DPPK dhe Komunës për transferimin e të drejtave të përdorimit tek fshatrat/komuna 	
6 Regjistrimi i dokumenteve të përdorimit të territorit nga përdoruesit	SHPPKK (Kryetari i SHPPKK dhe pylltari komunal), DSHP Kryetari i Këshillit të Komunës, Zyra Rajonale e Pronësisë mbi Tokën	Përfundimi i kontratave midis fshatit dhe përdoruesve	<ul style="list-style-type: none"> SHPPKK dhe pylltari komunal përgatisin dokumentet sipas përdoruesve; Kryetari i këshillit të Komunës miraton kontratat midis Kryetarit të fshatit dhe përdoruesve; Zyra Rajonale e pronësisë mbi Tokën lëshon certifikatën e "përdorimit" përdoruesve të pyjeve dhe kullotave. 	
7 Prioritizimi i ndërhyrjeve për zbatimin e planit të MPK në bazë fshati	Komisionet e fshatrave, SHPPKK (Kryetari i SHPPKK dhe pylltari komunal), EPM , DSHP	Përgatitja e planit të ndërhyrjeve	<ul style="list-style-type: none"> Komisionet e fshatrave propozojnë ndërhyrjet e nevojshme; Vëmendje e veçantë i duhet kushtuar sigurimit të mundësive për punë të paguar për të varfrit dhe gratë; SHPPKK dhe pylltari komunal përzgjedhin propozimet më të mira dhe përgatisin projektet për ndërhyrjet; DSHP miraton projektet e ndërhyrjeve Brenda 30 ditëve dhe siguron asistencë teknike. 	
8 Zbatimi i ndërhyrjeve të miratuara	Komisionet e fshatrave, SHPPKK (Kryetari i SHPPKK dhe pylltari komunal), Kryetari i Këshillit të Komunës, EPM, DSHP	Zbatimi i ndërhyrjeve të miratuara.	<ul style="list-style-type: none"> Marrëveshje për programin e investimeve midis Komunës dhe njësisë së menaxhimit të PZHBN; SHPPKK dhe Komuna organizojnë zbatimin e programit të investimeve; Komisioni i fshatit dhe përdoruesit realizojnë ndërhyrjet; DSHP ndjek procesin e zbatimit dhe jep asistencë teknike; Krijimi i "fondit të ri-investimit" në komunë nga kontributet e SHPPKK dhe grumbullimi i tarifave. 	Sipas programit të investimeve.

Burimi: Lako, Th., Male, J. Collaku, H. (2007)

Pyjet komunalë kanë pasur një ecuri të mirë gjatë viteve të fundit. Komunitetet tashmë janë më të ndërgjegjësuar se si ti mirëmbajnë pyjet e tyre dhe shembuj pozitivë mund të gjenden kudo. Transferimi i pyjeve në përdorim komunave ka çuar në përmirësimin e menaxhimit të pyjeve të degraduar duke rritur interesin dhe pjesëmarrjen e komuniteteve dhe pushtetit vendor. Megjithatë, kjo ecuri nuk është në harmoni me aftësitë dhe përfitimet e përdoruesve në pyjet komunalë. DSHP është akoma institucioni qeveritar zyrtarisht përgjegjës për kontrollin dhe menaxhimin e pyjeve në rreth. Gjithashtu, DSHP ka kompetencat për menaxhimin, kontrollin dhe monitorimin e pyjeve shtetërorë, si dhe të pyjeve komunalë.

Kuadri ligjor për pyjet komunalë nuk është ende i plotë. SHPPK dhe Njësitë e Qeverisjes Vendore (NQV) nuk kanë përgjegjësi të qarta ligjore për pyjet komunalë. Autoriteti aktual i DSHP, SHPPK dhe NJQV nuk është në linjë me modelin e zhvillimit të pyjeve komunalë, ku NJQV dhe komuniteti duhet të kenë aftësi të mira për menaxhimin e pyjeve komunalë. Në modelin e pyjeve komunalë, DSHP duhet të luajë më tepër një rol këshillues dhe monitorues. Prandaj menaxhimi i pyjeve komunalë duhet të transferohet tek SHPPK dhe NJQV duhet të marrin më tepër përgjegjësi për kontrollin dhe monitorimin e pyjeve komunalë.

Bazuar në legjislacionin Shqiptar për transferimin e pronave publike, të gjitha komunat kanë të drejtë të kërkojnë dhe regjistrojnë ligjërisht prona publike, përfshirë pyjet, në përdorim apo në pronësi, sipas interesave të komunës. Tashmë ky proces ka përfunduar në të gjitha komunat e Shqipërisë dhe kjo do të thotë që njohja e pyjeve si pronë e komunës do të fuqizojë të drejtat e pronësisë në pyje. Për të pasur një ndikim real tek përdoruesit e pyjeve, hapi tjetër do të jetë sigurimi i të drejtave të pronësisë/përdorimit për fshatrat, familjet dhe individët.

Pronësia dhe përgjegjësia e qartë për pyjet komunalë mbështetet me ngritjen e kapaciteteve të pushtetit vendor nëpërmjet rregulloreve dhe planifikimit me pjesëmarrje. Kjo mund të sjellë një kontribut të ndjeshëm në një decentralizim më efektiv dhe menaxhim më të mirë të pyjeve.

3.2.3 Krijimi i shoqatave të përdoruesve të pyjeve dhe kullotave

Për të qenë në gjendje të realizojnë menaxhimin e pyjeve komunalë, të gjithë përdoruesit e pyjeve komunalë anëtarësohen në SHPPK. Procesi i pyjeve komunalë mbështet përmirësimin e menaxhimit të njerëzve dhe pyjeve të tyre. SHPPK janë krijuar në bazë të ligjit Shqiptar për Organizatat Jo-Qeveritare (OJQ) (më vonë ndryshuar në organizata jo-fitimprurëse).

Anëtarë të SHPPK janë të gjithë përdoruesit e pyjeve komunalë. Shoqatat e përdoruesve të pyjeve dhe kullotave komunale mbështetin rritjen e pjesëmarrjes së fermerëve në menaxhimin e pyjeve të tyre, veçanërisht në zonat malore verilindore. Krijimi i SHPPK siguron pjesëmarrjen e komunitetit në menaxhimin e pyjeve komunalë. Shoqatat, ashtu si OJQ luajnë një rol shumë të rëndësishëm për organizimin e komuniteteve rurale dhe pjesëmarrjes aktive të tyre në përgatitjen dhe zbatimin e planeve të menaxhimit për pyjet komunalë. Organizimi dhe funksionimi i SHPPK-ve është ende i dobët, dhe ligjërisht shqetësimet kryesore janë në dy probleme:

- Banorët lokalë nuk kanë njohuri të mjaftueshme mbi ligjin për SHPPK.
- Banorët lokalë mendojnë se SHPPK caktohen nga NJQV apo nga DSHP.
- SHPPK nuk kanë mundësi të gjenerojnë të ardhura.

Bazuar në përvojat ekzistuese, komunat dhe SHPPK janë organizuar në nivel rajonal. Federatat Rajonale për Pyjet Komunalë janë ngritur për të mbështetur interesat e anëtarëve të tyre, komunat dhe SHPPK. Federatat luajnë një rol të rëndësishëm për lobimin në nivel rajonal dhe përfaqësojnë interesat e komuniteteve në nivelet më të larta përsa i përket pyjeve komunalë. Federatat, nëpërmjet

programeve të ndërgjegjësimit në nivel fshati, po rrisin aftësitë e SHPPK dhe komunave për të menaxhuar në mënyrë të qëndrueshme burimet e tyre.

Në vitin 2004, federatat rajonale u mblodhën dhe vendosën që u nevojitej një përfaqësim në nivel kombëtar për të promovuar interesat e anëtarëve të tyre. Në vitin 2005, me ndihmën e SNV, u krijua Shoqata Kombëtare Pyjeve dhe Kullotave Komunale (SHKPKK). Me krijimin e SHKPKK, që përfaqësonte federatat rajonale në nivel kombëtar, Federatat u bënë të njohura edhe në nivel kombëtar (Fig.2). Me ekspertizën e tyre ekzistuese dhe mbështetjen e dhënë nga organizatat ndërkombëtare, ato po punojnë për funksionimin sa më mirë të federatave.




Figura 2. Shoqatat e Përdoruesve të Pyjeve dhe Kullotave dhe lidhjet e ture me NJQV dhe Shërbimin Pyjor

SHKPKK dhe federatat rajonale po japin më tepër mbështetje dhe shërbime për anëtarët e tyre, komunat dhe SHPPK. Ato po luajnë rolin e tyre përfaqësues në nivel kombëtar duke adresuar interesat e anëtarëve të tyre. SHKPKK dhe federatat rajonale ekzistuese janë duke lobuar për përmirësimin e ligjit të pyjeve dhe veçanërisht ligjin e ri të aprovuar së fundmi, duke i kërkuar qeverisë të marrë në konsideratë përvojën dhe nevojat e komuniteteve lokale dhe SHPPK. Qeveria dhe institucionet e tjera shtetërore e kanë pranuar kërkesën e tyre për rishikimin dhe amendimin e ligjit të pyjeve.

Ndërgjegjësimi i komunitetit është i rëndësishëm dhe SHPPK luajnë një rol udhëheqës në menaxhimin e pyjeve komunalë. Përdorimi dhe menaxhimi i pyjeve komunalë duhet bërë nga banorët lokalë, prandaj është shumë e rëndësishme për ta të kuptojnë konceptin e Menaxhimit të Pyjeve Komunalë. Gjithnjë e më tepër komunitete lokale po ndërgjegjësohen për të marrë pjesë në menaxhimin e pyjeve komunalë për të ndërtuar një të ardhme më të mirë si për komunitetin dhe për pyllin.

Për të garantuar qëndrueshmërinë afatgjatë është e rëndësishme të harmonizohen përgjegjësitë midis SHPPK, DSHP dhe DPPK për menaxhimin e pyjeve dhe kullotave komunalë. Roli i DSHP është duke u rritur në disa çështje dhe nivele të menaxhimit të pyjeve. Megjithatë, DSHP ende ndjehet si institucioni i vetëm në gjendje për të menaxhuar pyjet komunalë edhe pse në të kaluarën kjo formë menaxhimi ka dështuar.

3.3 Organizimi i pronarëve të pyjeve privatë

Sipas të dhënave të vitit 1945, pyjet privatë në Shqipëri zinin 63,000 ha nga 1,379,000 ha që ishte sipërfaqja e përgjithshme e pyjeve. Pas 1945, filloi procesi i shtetëzimit masiv të pronës private dhe disa vjet më vonë koncepti i pronës private u harrua. Njohja dhe rikthimi i pyjeve privatë ish pronarëve filloi pas viti 1996. 19,000 ha ose 30% e sipërfaqes së pyjeve private u janë kthyer pronarëve deri në Dhjetor 2007 [informacion i DPPK]. Prosesi i rikthimit është shumë i ngadaltë dhe ish pronarët po përballen me probleme të ndryshme lidhur me menaxhimin e pyjeve të tyre.

Zhvillimi i ekonomisë së tregut hapi horizonte të reja për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme në sektorin e pyjeve private. Dhënia me qira e tokës pyjore për kultivimin e bimëve mjekësore-eterovajore, përmirësimi i pyjeve të degraduara apo pyllëzimet janë disa nga mundësitë për nxitjen e zhvillimit të pyjeve privatë. Partneriteti i sektorit privat dhe shtetëror krijon mundësi të tjera për të ndaluar degradimin e mëtejshëm të pyjeve dhe përmirësimin e tyre.

Në Shqipëri, politika për menaxhimin e pyjeve privatë nuk është e plotë dhe procedurat për zbatimin e saj nuk ekzistojnë ende. Dispozitat ligjore nuk reflektojnë ndryshimet aktuale në menaxhimin e pyjeve privatë. Ligji i pyjeve dhe Strategjia për Zhvillimin e Sektorit të Pyjeve dhe Kullotave i përmendin tangencialisht pyjet private, pa përcaktuar qëllimet dhe mënyrat për menaxhimin e qëndrueshëm të tyre.

Mungesa e organizimit të pronarëve të pyjeve privatë është një nga çështjet kryesore në menaxhimin e pyjeve privatë. Përpjekje janë bërë nga Programi për Zhvillimin e Pylltarisë Privatë në Shqipëri (APFDP) gjatë periudhës 1998-2000 për krijimin e shoqatës së parë rajonale të Pronarëve të Pyjeve Privatë (PPP) në qarkun e Fierit. Shoqata rajonale e PPP u regjistrua dhe filloi aktivitetin e saj me mbështetjen e APFDP. Me përfundimin e këtij programi edhe shoqata pushoi së ekzistuari.

Ligji për pyjet dhe ligji për kthimin dhe kompensimin e pronave ish pronarëve parashikojnë kthimin e pyjeve ish pronarëve. Kthimi mund të kryhet deri në 100 ha për pronarët e pyjeve. Këto ligje përmendin detyrimin e pronarit për tu kujdesur për ruajtjen dhe zhvillimin e këtyre burimeve natyrore. Para 1945 sipërfaqja e pyjeve private ishte 63,000 ha apo 5% e sipërfaqes totale të pyjeve. Shumica e këtyre pyjeve, kryesisht në zona të ulëta, u kthyen në toka bujqësore. Deri në 2007 janë kthyer rreth 19,000 ha pyje.

Pronarët privatë po përballen më një sërë vështirësish në menaxhimin e pyjeve të tyre. Pronari i pyllit privat është përgjegjës për masat mjedisore në territorin që përdoret për prodhime drusore, apo kullotë bagëtish, dhe për kostot e këtyre masave. Ata duhet të lënë pa prekur nga pylli habitate të vogla, normalisht më pak se 0.5 ha, për llojet e rralla apo të rrezikuara të florës dhe faunës. Sidoqoftë, në rast se kostot janë shumë të larta shteti duhet kompensojë pronarin

Problemet e mëposhtme e bëjnë të vështirë procesin e kthimit:

- Nuk ka dispozita ligjore që rregullojnë marrëdhëniet dhe sqarojnë të drejtat dhe detyrimet midis pronarit privat, shërbimit pyjor dhe pushtetit vendor, apo midis vetë pronarëve.
- Kthimi i pyjeve në zona turistike (ndërkohë që lejohet kthimi i tokës bujqësore) apo zona të mbrojtura nuk lejohet. Në këto raste pronarët duhet të kompensohen.
- Mungojnë dokumentet e pronësisë.
- Dispozitat ligjore lidhur me kthimin e pyjeve nuk njihen sa duhet.
- Pronarët privatë nuk kanë njohuritë teknike për menaxhimin e pyjeve.

Objektivat afatgjatë për pyjet privatë janë: kthimi i gjithë pasurive pyjore ish pronarëve, mbrojtja dhe menaxhimi i qëndrueshëm i tyre për plotësimin e nevojave dhe sigurimin e të ardhurave, bashkë me kryerjen e shërbimeve mjedisore e sociale.

Komponentët e programit të propozuar për zhvillimin e pylltarisë private janë:

- Përmirësimi i politikave dhe kuadrit ligjor për kthimin e plotë të pyjeve ish pronarëve, përfshirë edhe ato në zonat turistike dhe zonat e mbrojtura me rëndësi lokale, për përcaktimin e marrëdhënieve midis pronarëve privatë, shërbimit pyjor dhe pushtetit vendor, apo edhe midis vetë pronarëve, me të drejta e detyrime të qarta, për dhënien me qira të tokës pyjore apo tokave të pandara për aktivitete private.
- Përsheptimi i procesit të kthimit të pyjeve, duke siguruar mbështetje teknike për pronarët që të plotësojnë dokumentacionin e nevojshëm për kthimin e pronës dhe për përgatitjen dhe zbatimin e planeve të menaxhimit.
- Aplikimin e një sistemi fiskal të favorshëm për pronarët privatë, përcaktimi i incentivave financiare për të mbështetur zhvillimin e pyjeve privatë.
- Krijimi i lehtësirave për kredi të buta afatgjata për përmirësimin dhe shtimin e pyjeve, duke pasur parasysh ciklin e gjatë të prodhimit të pyjeve
- Trajnimi i pronarëve privatë mbi dispozitat ligjore për kthimin e pronave, mbrojtjen dhe menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve të tyre.
- Mbështetja e pronarëve privatë për tu organizuar në shoqata, mbështetja nëpërmjet shërbimit këshillimor, shkëmbimi i teknologjive dhe informacionit dhe përhapja e praktikave më të mira për menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore

4 Zhvillimet më të fundit politike për pyjet komunalë e privatë

4.1 Orientimet bazë për sektorin e pyjeve

Është e nevojshme të shpejtohet procesi i decentralizimit të qeverisjes së pasurive natyrore dhe përmirësimit të kuadrit ligjor të tij, kthimi i pyjeve e kullotave ish-pronarëve, transferimi për përdorim komunal dhe hapja e rrugës për privatizimin e këtyre pasurive sipas kriterëve rigorozë e nën kontrollin e nevojshëm. Gjatë këtij procesi kanë lindur e do të lindin edhe në të ardhmen probleme social-ekonomike, por ato duhen sqaruar me mirëkuptim e konsensus për të evituar konfliktet, duke mbajtur parasysh interesat e të gjitha palëve.

Roli i Qeverisë Shqiptare po ndryshon në drejtim të mbrojtjes dhe qeverisjes siç duhet të burimeve natyrore. Prioritete të Qeverisë janë, ndër të tjera, mbrojtja dhe menaxhimi i burimeve natyrore, në mënyrë që të sigurojnë zhvillim social dhe të promovojnë një zhvillim të qëndrueshëm, është deklaruar nga Qeveria që në vitin 1992. Kryeministri i vendit ka theksuar se "Veçanërisht kujdes duhet të behet për të konsideruar ndërhyrje të menjëhershme që lidhen me shfrytëzimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore: pyjeve, kullotave dhe zonave të mbrojtura, të cilat në mënyrë paradoksale nuk konsiderohen si burim të ardhurash për fshatin dhe po shpërdorohen, megjithëse zënë me shume se gjysmën e sipërfaqes së vendit. Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit duhet të ndryshojë e para konceptin tradicional mos vlerësues për këtë pasuri të çmuar. Thelbi i reformave duhet të çojë edhe në shpejtimin e transferimit tek komunat të një pjese të sipërfaqes pyjore për përdorim e menaxhim, realizimin e një reforme të thelle institucionale, që bazohet në ndarjen e funksioneve të menaxhimit e të kontrollit, duke krijuar sa më parë një inspektorat pyjor me vete, zgjerimin e sipërfaqes së zonave të mbrojtura dhe hartimin e planeve të menaxhimit të tyre, si dhe mënyrat e rritjes së të ardhurave të komunave nga këto pasuri natyrore. Kjo pakete reformash, së bashku me përmirësimet e nevojshme ligjore, duhet të paraqitet për miratim në Këshillin e Ministrave brenda muajit Prill të këtij viti" (deklaratë e Kryeministrit të Shqipërisë në analizën vjetore të Qeverisë për vitin 2003, më 28 Janar 2004.

4.2 Synimet e sektorit të pyjeve

Orientimet e Qeverisë, së bashku me përvojat pozitive në pyje e kullota dhe materialet e ndryshme të hartuar me grupe pune nga DPPK, janë bazë për përcaktimin e synimeve të sektorit të pyjeve e kullotave, përmirësimin e politikave dhe dispozitave ligjore përkatëse. Ndërkaq, duhen mbajtur parasysh dhe ndikimet e jashtme mbi sektorin, si: zhvillimet ekonomike, politike, demografike dhe sociale, të cilat ndikojnë mbi formulimin e politikave kombëtare pyjore dhe rregullimet institucionale, mbi menaxhimin e pyjeve.

Krijimi i një kuadri institucional të përshtatshëm është i nevojshëm për zhvillimin e pyjeve dhe kullotave në të ardhmen. Me tej, nevojitet një sistem i përshtatshëm institucional me kompetenca dhe autoritet për kryerjen e veprimtarive të ngarkuara. Po ashtu, kërkohet zhvillimi i kërkimit shkencor dhe arsimit, për të siguruar përhapjen e njohurive dhe krijimin e specialisteve të afte për menaxhimin e pyjeve.

Në deklaratën e Ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit të Prillit 2003 për rishikimin e politikave dhe të Strategjisë së Sektorit të Pyjeve dhe Kullotave, evidentohen dy orientime kryesore:

1. Të sigurohet ruajtja dhe mbrojtja e integritetit të kësaj pasurie natyrore të qëndrueshme, e në këtë kuadër edhe mbrojtja e biodiversitetit pyjor e kullosor; dhe
2. Ekonomia pyjore të kontribuojë në zbutjen e varfërisë në zonat rurale

Strategjia e përgatitur për zhvillimin e pyjeve dhe kullotave, e cila është miratuar nga qeveria në Prill 2004, ka 5 synime kryesore:

1. Sigurimi i integritetit territorial, ekologjik dhe i biodiversitetit të pyjeve e kullotave;
2. Nxitja dhe mbështetja e menaxhimit të qëndrueshëm të burimeve pyjore e kullosore;
3. Ngritja dhe forcimi i lidhjeve me ekonominë e tregut;
4. Përfshirja e partnereve dhe përdoruesve vendor në ruajtjen dhe zhvillimin e pylltarisë;
5. Reforma institucionale dhe ligjore e shërbimit pyjor në nivel kombëtar dhe vendor.

Në rrugën drejt asociimit në BE kërkohet që reforma politike, ligjore dhe institucionale të përfaqesojnë gradualisht me standardet Evropiane për ruajtjen dhe qeverisjen e qëndrueshme të pyjeve.

Kryesore është rivendosja e besimit në vetvete për përdorimin dhe menaxhimin e pyjeve, dhe e besimit tek njerëzit ndaj administratës pyjore. Rivendosja e të drejtave të popullsisë vendase mbi pyjet është e nevojshme, sikurse dhe rritja e përgjegjësisë së administratës shtetërore për mbrojtjen e pyjeve. Shërbimi Pyjor duhet të jetë në krye të ndryshimeve rrënjësore për përmirësimin e situatës në sektor. Personeli pyjor duhet të ri-orientohet dhe përqendrohet ndaj kërkesave të reja për shërbimet që kërkohen prej pyjeve. Mungesa e preokupimit të politikaneve për sektorin pyjor nuk mund të përdoret si justifikim për mungesë përpjekjesh profesionale nga ana e personelit pyjor. Ndërkaq, duhet që edhe sektorët e tjerë të bashkohen me këto përpjekje. Fshataret duhen inkurajuar të mbrojnë dhe shtojnë pyjet; po ashtu, duhen marrë masa që prej këtij procesi ata të ndiejnë përmirësime në jetesën e tyre.

OJF-te vendore, shkollat dhe masmedia duhet të lehtësojnë komunikimin, organizimin, monitorimin dhe vlerësimin e punës së bërë; ky proces është në një linjë me misionin e tyre për të ndihmuar në zhvillimin rural. Ato duhet të planifikojnë se si mund të luajnë një rol katalitik dhe mbështetës në ruajtjen e pyjeve dhe zhvillimin rural. Qeveria qendrore dhe organet e qeverisjes vendore, sektori i biznesit dhe shoqëria civile janë të ndërgjegjshëm për ndikimet negative të shpyllëzimeve dhe degradimeve në mjedisin pyjor e kullosor, por kanë munguar programe zhvillimi afat-gjata për sektorin.

Janë mjaft partnerë të interesuar për sektorin e pyjeve e secili prej tyre duhet të planifikojë përfshirjen e vet në këtë proces zhvillimi. Komunat dhe fshatrat duhet të planifikojnë zhvillimin dhe menaxhimin e pyjeve dhe kullotave që u janë dhënë në përdorim, me që lidhen me jetesën e tyre. Sektori industrial duhet të planifikojë se si procesi i prodhimit do të furnizojë me produkte të ndryshme sipas kërkesave të tregut.

Ministria e Mjedisit Pyjor dhe administrimit të Ujërave (MMPAU) është nyja kyçe për përcaktimin e objektivave të zhvillimit të sektorit, për analizën e gjendjes, përcaktimin e varianteve të mundshme për zgjidhje, dhe formulimin e hapave për arritjen e zgjidhjeve të përshtatshme, si dhe për vlerësimin e ndikimeve të mundshme të hapave të parashikuara. Masat e parashikuara në nivel kombëtar, me tej, duhen materializuar nëpërmjet planeve dhe vendimeve në nivel vendor.

MMPAU është vetëm në gjysmë të rrugës të ciklit të planifikimit. Ai duhet pasuar nga plane operacionale në nivel vendor në një proces nga poshtë-lart. Tashmë po zbehet monopoli i shtetit mbi konservimin dhe menaxhimin e pyjeve dhe kullotave dhe po forcohet roli i komuniteteve vendore, të cilët kanë të drejtën të marrin vendime për pyjet e dhëna në përdorim.

4.3 Administrimi i pyjeve komunalë

Procesi i transferimit të pyjeve shtetërore në përdorim komunal ka filluar në vitin 1996, mbështetur në ligjin për pyjet, dhe në Rregulloren 308 të vitit 1996. Qeveria ka deklaruar objektivin për transferimin e 40% të pyjeve në përdorim të përbashkët të fshatrave apo familjeve fshatare. DPPK në bashkëpunim me pushtetin vendor, me DSHP-te, Projektin e Pyjeve financuar nga BB, dhe Projektin për Zhvillimin e Pylltarisë Private financuar nga USAID, kanë mbështetur procesin e transferimit.

Tre qëllimet e transferimit janë: (i) lehtësimi dhe plotësimi sa me mire i nevojave të popullsisë lokale me lende, dru zjarri, ushqim për blegtorinë, bime mjekësore, prodhime të dyta pyjore dhe dobi të tjera që siguron pylli; (ii) ruajtja e mjedisit natyror; dhe (iii) rritja e të ardhurave në nivel vendor.

Megjithëse politikat dhe dispozitat ligjore për pyjet komunale nuk janë të plota, procesi i transferimit ka ecur pa pengesa dhe është vlerësuar pozitivisht nga pushteti vendor e fshataret. Përvoja e re e krijuar pas procesit të transferimit, është hartimi dhe plotësimi i planit të mbarështimit të pyjeve komunale në baze komune, me pjesëmarrjen e komunitetit. PP i BB ka investuar për hartimin e planeve të mbarështimit, përmirësimin dhe pyllëzimin e pyjeve komunale.

Investimet për përmirësimin e pyjeve komunale kanalizohen nëpërmjet Shoqatave të Përdoruesve të Pyjeve e Kullotave Komunale (SHPPKK) të çdo komune. Ky komponent ka ndikim direkt në reduktimin e varfërisë së familjeve fshatare, pasi Shoqatat jo vetëm punësojnë fshataret për punimet pyjore, por vetë fshati është përfituesi kryesor nga puna që bëhet. Mbrojtja dhe përmirësimi i pyjeve dhe kullotave ka filluar në komunat/fshatrat e përfshira në procesin e transferimit në shkallë të gjere, ku dhe janë fituar përvoja të vlefshme. Sipërfaqe të tera pyjesh janë përmirësuar gjatë zbatimit të planeve të menaxhimit nga Shoqatat, por dhe me iniciativa private. Në këtë kuadër, pozitiv është rigjallërimi i disa praktikave tradicionale të "rrethimit social" (ndalimi përkohësisht i kullotjes për mëkëmbjen e pyjeve të degraduar, jo thjesht nëpërmjet rrethimit qofte dhe me një gardh të thjeshtë – i cili përsëri mbetet mjaft efektiv- por nëpërmjet rregullave të vendosura nga komuniteti).

Objekti afatgjatë për transferimin e pyjeve komunale duhet të jetë garantimi ligjor i të drejtave të përdoruesve të pyjeve komunale, për t'i bërë ata plotësisht të interesuar për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e tyre. Synimi i mëtejshëm duhet të jetë privatizimi i tyre sipas kushteve të caktuara.

Programi për zhvillimin e pyjeve komunale përfshin:

- Garantimi ligjor i të drejtave të përdoruesve dhe pajisja e tyre me dokumentacionin ligjor të transferimit.
- Shpejtimi dhe thellimi i procesit të transferimit, duke përfshirë me gjere përdoruesit në hartimin dhe zbatimin e planeve të menaxhimit të pyjeve të tyre.
- Të mos ketë limite për përqindjen e sipërfaqes së pyjeve dhe kullotave për transferim në shkallë kombëtare, komune apo përdoruesi dhe as limite kohore. Sipërfaqet të caktohen me marrëveshje midis pushtetit vendor, shërbimit pyjor dhe përdoruesve, në varësi të kushtet, traditën dhe interesat kombëtare, duke mbajtur parasysh plotësimin e nevojave të përdoruesve me prodhime të shërbimeve.
- Planet e menaxhimit të pyjeve komunale të hartohen e zbatohen në baze fshati, si njësi me kompakte e homogjene e komunitetit vendor, me lidhje fisnore e tradita në qeverisjen së bashku të pasurive natyrore, dhe që përben një zonë kadastrale, brenda së cilës regjistrohen të gjitha pasuritë natyrore.
- Përgatitja e programeve për mbrojtjen dhe zhvillimin e pyjeve, kullotave dhe pasurive natyrore me karakter vendor, në kuadrin e zhvillimit ekonomik vendor, nga komunat dhe bashkitë, si funksione të rëndësishme të tyre.
- Krijimi i instrumenteve financiare dhe nxitës për të mbështetur zhvillimin e pasurive natyrore në zonat rurale.
- Ngritja e kapaciteteve dhe kualifikimi i drejtuesve dhe specialisteve të pushtetit vendor e DSHP-ve për procesin e transferimit, për kompetencat, rolin dhe përgjegjësitë përse i përket qeverisjes së pyjeve komunale, si dhe pasurive të tjera natyrore.
- Kryerja e studimeve dhe analizave të rezultateve dhe përvojave të transferimit e menaxhimit të pyjeve komunale nga specialiste të shërbimit pyjor, pushteti vendor, Fakulteti i Shkencave Pyjore dhe Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve, si dhe dhënia e rekomandimeve të nevojshme.

- Zhvillimi i proceseve pjesëmarrëse, ndërgjegjësimi i përdoruesve dhe shkëmbimi i informacionit. Organizimi me i mire dhe shtrirja e shërbimit këshillimor tek fshataret për të njohur dhe përhapur praktikat me të mira për menaxhimin e qëndrueshëm të pasurive natyrore komunale, trajnimi i pylltarëve komunale dhe i shoqatave të përdoruesve të pyjeve komunale,
- Përfshirja e procesit të transferimit dhe menaxhimit të pyjeve komunale në programet mësimore të Fakultetit të Shkencave Pyjore dhe të Shkollës së Mesme Pyjore të Shkodrës.
- Studimi dhe përcaktimi i rrugëve e mjeteve për sigurimin e vazhdimësisë së SHPPKK, bërja e tyre të interesuar për qeverisjen e këtyre pasurive natyrore, duke rritur të ardhurat dhe efektivitetin nga menaxhimi i qëndrueshëm i pyjeve komunale.

5 Përmbledhje e procesit kryesor të politikë-bërjes

5.1 Hyrje

Duke njohur ndryshimet thelbësore që kanë ndodhur në vend që prej vitit 1991 dhe rëndësinë e vazhdueshme të bujqësisë në ekonominë e vendit, Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit hartoi 'Strategjinë e Zhvillimit të Bujqësisë' e njohur edhe si "Strategjia e gjelbër". Ajo është bazuar në Kushtetutën e RSH, e cila thekson se "Shteti synon një shfrytëzim racional të pyjeve, ujërave, kullotave, bazuar në parimin e zhvillimit të qëndrueshëm". Strategjia e gjelbër është miratuar nga Këshilli i Ministrave. Strategjia për përdorimin e pyjeve dhe kullotave ishte përfshirë në strategjinë e gjelbër.

Kjo strategji u përgatit me kërkesë të Ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit për të udhëhequr zhvillimin e pyjeve në të gjithë vendin dhe për të siguruar kontributin optimal të tyre në rritjen social ekonomike dhe zhvillimin e qëndrueshëm të vendit. "Strategjia për zhvillimin e sektorit të pyjeve dhe kullotave" (SZSPK) u hartua nga një grup pune me specialistë me përvojë dhe nën drejtimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Pyjeve dhe Kullotave, gjatë periudhës Prill-Maj 1998, me mbështetjen e Programit për Zhvillimin e Pylltarisë Private në Shqipëri (APFDP) financuar nga USAID.

Metodologjia për formulimin e strategjisë ka qenë relativisht e thjeshtë dhe e drejtpërdrejtë. Bazuar në ekspertizën e anëtarëve të tij dhe dokumenteve më të fundit, grupi i punës shqyrtoi situatën e përgjithshme të pyjeve duke evidentuar mundësitë specifike dhe sfidat me të cilat përballëj vendi. Më pas, ai ekzaminoi këto mundësi dhe sfida nën dritën e deklaratave politike ekzistuese lidhur me zhvillimin e pyjeve, duke pasur parasysh nevojën për vendime të tjera politike lidhur me situatën e re.

Strategjia e gjelbër u pasua në vitin 1999 nga formulimi i të parës strategji për zhvillimin e pyjeve në Shqipëri. Strategjia e pyjeve synonte të jepte një kontribut optimal dhe rritjen ekonomike dhe menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve nëpërmjet:

- Sigurimit të orientimeve bazë për strukturimin dhe zhvillimin e institucioneve dhe agjencive publike që do të drejtojnë zbatimin e programit të pyjeve;
- nënvizimit të lidhjeve dhe rëndësisë thelbësore të pyjeve për arritjen e objektivave të zhvillimit në sektorët e tjerë – bujqësia, energjia, uji, zhvillimi rural dhe turizmi - duke lehtësuar kështu përmirësimin e koordinimit të planeve dhe programeve;
- sigurimit që autoritetet qeveritare të nivelit të lartë kanë një kuptim të qartë mbi kontributin potencial të pyjeve në zhvillimin kombëtar duke siguruar kështu mbështetjen e saj me politikën, autoritetin dhe burimet e nevojshme
- lehtësimin të mbështetjes ndërkombëtare për pyjet duke lejuar partnerët e interesuar për zhvillim të shohin si burimet e tyre mund dhe do të përdoren në mënyrën më të mirë
- stimulimit të stafit publik të pyjeve për të kryer detyrat e tyre dhe rritjen e përfshirjes së femrave
- kapërcimit të paqartësive në sektorin privat që mund të pengojnë investimet pozitive (p.sh., për industrinë drurit apo zhvillimin e turizmit), dhe në nivel lokal, midis fermerëve, barinjve dhe popullsisë rurale, të cilat do të ndihen më të sigurt në ruajtjen dhe menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve të tyre pyjore,
- arritjes së objektivave të matshëm dhe rishikimit të planeve sipas ndryshimit të rrethanave.

Bazuar në strategjinë e pyjeve, në vitin 1999 DPPK përgatiti një plan racional veprimi për zhvillimin e pylltarisë, si stimuli i vetëm e më bindës për arritje konkrete e afatgjata në të gjithë vendin.

5.2 Kuadri politik

Qeveria ka bërë një sërë ndryshimesh në ligjet dhe rregulloret që përbëjnë strukturën politike e ligjore të pyjeve. Këto ndryshime do të vazhdojnë pasi Qeveria dhe shoqëria fitojnë eksperiencë dhe identifikojnë nevojat për rregullimin e politikave.

Në Shqipëri, ri-orientimi thelbësor i modelit social ekonomik prodhon një sërë mandatesh makro ekonomike e sociale, brenda të cilave duhen formuluar të gjitha politikat sektoriale. Këto mandate përfshijnë:

- njohjen e të drejtave të pronës private dhe privatizimin e pronës publike;
- decentralizimin dhe fuqizimin e rolit dhe kapaciteteve të pushtetit vendor;
- transformimin e vazhdueshëm drejt ekonomisë së tregut;
- rritjen e pjesëmarrjes dhe mbështetjes popullore për rolin e organizatave jo-qeveritare
- racionalizimin e rolit të qeverisë, reformën institucionale dhe rritjen e efektivitetit dhe efikasitetit në përdorimin e burimeve qeveritare
- angazhimin serioz për modernizimin e bujqësisë dhe blegtorisë.

Gjithashtu, strategjia ka marrë parasysh edhe premisat specifike që lidhen me situatën e veçantë në Shqipëri, ku përfshihen:

- Rëndësia e kombinimit të vitalitetit dhe përshtatshmërisë së sektorit privat, i cili ka demonstruar gjerësisht aftësitë e tij që me privatizimin e tokës bujqësore me një rritje të qëndrueshme të prodhimit, madje edhe përballë paqartësive.
- Rëndësia e evitimit të fragmentimit të mëtejshëm të burimeve pyjore çka minon menaxhimin e tyre.
- Pranimi se pronësia e tokës duhet të jetë e qartë dhe shteti nuk duhet të vendosë rregulla të tepërta për pronësinë e drurëve. Ka nevojë për plane menaxhimi të thjeshta e të drejtpërdrejta për qeverisjen dhe përdorimin e pyjeve komunalë dhe privatë, si dhe procedura efektive për përgatitjen, miratimin dhe zbatimin e tyre.
- Angazhimi që arritet në decentralizimin brenda sektorit të pyjeve duhet të arrihen nëpërmjet rritjes së konsultimit me stafin territorial dhe marrjes së vendimeve politike e programore nën dritën e eksperiencës së terrenit
- Nevoja për një pjesëmarrje më të mirë të aktorëve dhe rritje e transparencës në planifikimin, vendim-marrjen dhe shpërndarjen e të drejtave dhe lejeve për përdorimin e burimeve
- Nevoja për një përjasje ndër-sektoriale, ndër-institucionale për adresimin e problemeve të shumta më të cilat përballen pyjet
- Nevoja për të pranuar që gratë luajnë një rol kritik në pyje dhe strategjia synon të zgjerojë mundësitë e grave për të rritur kontributin e tyre në zhvillimin e pylltarisë
- Nevoja për të marrë parasysh konventat ndërkombëtare të firmosura nga Shqipëria. Bashkëpunimi me institucionet dhe agjencitë ndërkombëtare do të forcohet ashtu si dhe pjesëmarrja e Shqipërisë në projekte me interes të dyanshëm, duke i dhënë prioritet projekteve me vendet fqinje.
- Menaxhimi i bazuar në konceptet e përdorimit të shumëfishtë të produkteve dhe shërbimeve pyjore;
- Reduktimi gradual i varësisë nga drutë e zjarrit për energjinë shtëpiake
- Nevoja për kontrollin e erozionit dhe mbrojtjen e basene ujëmbledhës
- Rritja e vëmendjes ndaj ruajtjes së biodiversitetit

5.2.1 Qëllimet e Politikës Pyjore sipas SZSPK

Më poshtë jepet një përmbledhje e qëllimeve socio-ekonomike dhe teknike të politikës për sektorin e pyjeve:

1. **Ruajtja e integritetit të burimeve pyjore**
 - Qartësimi i vendimeve lidhur me pozicionin eventual të pyjeve shtetërore
 - Reformimi i qëndrimit ndaj sistemit të kategorizimit të tokës në procesin e planifikimit dhe zhvillimit të përdorimit të territorit.
2. **Menaxhimi i qëndrueshëm me synim plotësimin e nevojave të tashme dhe të ardhme për produkte dhe shërbime pyjore**
 - Përmirësimi i mjeteve për planifikimin në pyje dhe përdormi i tyre.
 - Rritja e burimeve financiare në dispozicion të menaxhimit dhe ruajtjes së pyjeve publike.
 - Ngritja e kapaciteteve të sektorit publik dhe privat për menaxhimin e burimeve natyrore.
3. **Tranzicioni drejt ekonomisë së tregut në pyje**
 - Zgjidhja e paqartësive në sektorin privat lidhur me funksionimin e tregut dhe disponibilitetit të lëndëve të para.
 - Vazhdim i promovimit të mundësive të pyjeve dhe terreneve natyrore për zhvillimin e ndërmarrjeve ë vogla për punësim dhe diversifikim të ardhurash
4. **Transferimi i pyjeve komunalë**
 - Zgjerimi dhe përsheptimi i programit të qeverisë për transferimin e pyjeve komunalë për të arritur objektivin e 40% të fondit pyjor brenda 3-5 viteve të ardhshme.
 - Sistemimi dhe thjeshtimi i procesit të transferimit të pyjeve komunalë.
 - Ri-formatimi i shërbimit këshillimor brenda DPPK me qëllim ri-orientimin e rolit të pylltarëve në menaxhimin dhe mbrojtjen e pyjeve.
5. **Përmirësimi i menaxhimit shtetëror të pyjeve prodhues**
 - Mbrojtja dhe përdorimi i pyjeve që do të mbahen nën kontroll nga DPPK (shteti).
 - Hartimi dhe zbatimi i një modeli të ri të menaxhimit të pyjeve.
 - Vazhdimin e fuqizimit institucional për zbatimin e menaxhimit modern, të qëndrueshëm dhe të orientuar drejt tregut.
6. **Zhvillimi i turizmit dhe aktiviteteve rekreative në natyrë**
 - Ndalimi i degradimit mjedisor të zonave të mbrojtura ekzistuese.
 - Vendosja e zonave të mbrojtura nën një sistem aktiv menaxhimi dhe promovimi i përdorimit racional e të shumëfishtë të zonave të mbrojtura dhe infrastrukturës së tyre.

Strategjia e parë nuk u fokusua në politikat e pyjeve privatë sepse kthimi i pyjeve ish pronarëve ishte në hapat e para.

5.2.2 Synimet e politikës pyjore sipas strategjisë së re të pyjeve (2004)

Rishikimi i strategjisë së zhvillimit të sektorit të pyjeve dhe kullotave kushtëzohet nga situata e vështirë e këtij sektori pas viteve 1990, i cili megjithëse okupon me shume se 50% të sipërfaqes së vendit ka nevojë për ndryshime thelbësore në menaxhimin e tij, të cilat duhet të jenë në linjë me politikat qeveritare për pyjet dhe mjedisin.

Vendimi i qeverisë, për të forcuar ruajtjen dhe funksionimin e të mirave publike të pyjeve dhe kullotave dhe ndalimin e përkohshëm të shfrytëzimit tregtar të burimeve pyjore, bën të nevojshme rishikimin dhe azhurnimin e Strategjisë për zhvillimin e sektorit të pyjeve dhe kullotave.

Strategjia e re për zhvillimin e sektorit të pyjeve u hartua mbi bazën e zhvillimeve social – ekonomike të vendit, reduktimit të varfërisë në zonat rurale, ndryshimeve thelbësore që kanë ndodhur e do të ndodhin në drejtim të lëvizjeve demografike dhe nevojës për një vlerësim shumë-funksional të burimeve pyjore e kullimore ku do të veçonim: pyjet si burim energjie, e si burim i prodhimeve parësore të biomasës, si burim i diversitetit biologjik dhe i sekuestrimit të karbonit etj. Ruajtja e vazhdueshme, përdorimi racional dhe vlerësimi i saktë i përfitimeve publike nga pyjet në përputhje me interesat e shtresave të ndryshme të shoqërisë mund të arrihet nëpërmjet një menaxhimi të qëndrueshëm e shumë-funksional.

Ne këtë stad të ri të integritit të Shqipërisë në strukturat Evropiane, pas një periudhe të mbi shfrytëzimit, mbikullotjes dhe keqadministrimit të burimeve pyjore, behet i rëndësishëm përditësimi i strategjisë për zhvillimin e sektorit të pyjeve, duke:

- Dhënë orientimet baze të zhvillimit të strukturave administrative, institucioneve politike dhe organeve që do të udhëheqin zbatimin e programeve të zhvillimit të këtij sektori.
- Theksuar lidhjet dhe rëndësinë themelore të sektorit të pyjeve dhe kullotave për plotësimin e objektivave të zhvillimit të sektorëve të tjerë si atij të bujqësisë, blegtorisë, energjetikës, ujërave, turizmit, zhvillimit rural në përgjithësi, duke mundësuar përmirësimin e planifikimit ndër sektorial dhe e koordinimit të programeve të zhvillimit të vendit.
- Kontribuar në rritjen e vetëdijes së autoriteteve të larta vendim-marrëse e administrative, komuniteteve të përdoruesve të burimeve natyrore, pyjore e kullimore, e publikut në përgjithësi, për një kuptim më të qartë lidhur me kontributin e mundshëm të sektorit pyjor e kullor në zhvillimin e përgjithshëm kombëtar, për ta mbështetur atë me politikën, autoritetin dhe burimet financiare të nevojshme.
- Bërë më të realizueshëm mbështetjen e organizmave ndërkombëtare partnere të interesuara për zhvillimin e sektorit të pyjeve dhe kullotave, duke parë shfrytëzimin efikas të kontributeve të tyre jo vetëm në planin kombëtar por dhe në atë rajonal e global.
- Duke parë veten si aktor dhe faktor të përpjekjeve dhe nismave për zhvillimin e sektorit pyjor e kullor, personeli pyjor do të angazhohet në një veprimtari me të përgjegjshme dhe me profesionale.
- Kontribuar në kapërcimin e vështirësive që pengojnë sektorin privat në ndërmarrjen e investimeve pozitive dhe nxit ndërmarrjen e sigurte nismave që kanë të bëjnë me ruajtjen dhe qeverisjen e qëndrueshme të burimeve natyrore, pyjore e kullimore.
- Siguruar një kuadër legjislativ, vlerësimi e monitorimi që të lejon matjen dhe sipas rrethanave ndryshimit e qeverisjes, bazuar në ecurinë progresive dinamike dhe në arritjen e synimeve politike.

Strategjia e re përfshin masat kryesore për menaxhimin e qëndrueshëm të sektorit të pyjeve, nëpërmjet

- Ndërprerja e biznesit të shfrytëzimeve tregtare për një periudhe të paktën 10 vjeçare nëpërmjet riorganizimit dhe rritjes së kontrollit.
- Vazhdimi i procesit të transferimit të pyjeve dhe kullotave tek organet e qeverisjes vendore drejt kalimit tek komunitetet e drejtave të plota mbi pronësinë.
- Ruajtja dhe rehabilitimi i pyjeve dhe kullotave nëpërmjet rritjes së investimeve dhe nxitjes së iniciativave private e kolektive.
- Qeverisja e qëndrueshme e pyjeve.
- Vendosja e një sistemi monitorimi për ndjekjen në kohe të proceseve dinamike në pyje dhe kullota dhe për ndërhyrjen në kohe për rehabilitimin e tyre.
- Nxitja e nismave individuale ose kolektive për ripyllëzimin e tokave të zhveshura dhe të abandonuara.

- Ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i diversitetit biologjik ne ekosistemet pyjore dhe kullosore
- Ruajtja dhe përmirësimi i përshtateshe i funksioneve mbrojtëse të menaxhimit të pyjeve (ne mënyre të veçantë mbrojtjen e tokës, të sasisë dhe cilësisë se ujërave)
- Ruajtja e funksioneve dhe shërbimeve te tjera social-ekonomike, si dhe sigurimi i përfitimeve te shumëfishta për shoqërinë, për brezat e sotëm dhe te ardhshëm.

Pylltaria private nuk është marrë në konsideratë në strategjinë e re, si në atë të vjetrën, ndoshta për arsyen se pyjet privatë janë nënvlerësuar.

6 Pylltaria private/Komunale në procesin e PKP/SKP

6.1 Sfidat e decentralizimit të menaxhimit të pyjeve

Procesi i decentralizimit, në termat e përgatitjes së kuadrit ligjor dhe transferimit të pronave publike (përfshirë pyjet) është duke bërë hapa para. Tetë vjet më parë, Qeveria Shqiptare filloi zbatimin e procesit të krijimit të një inventari të pronave publike. Procesi mori shumë kohë pasi duheshin ndjekur një sërë procedurash. Procesi i organizua në tre faza: inventarizimi, transferimi dhe regjistrimi. Deri tani shumica e komunave/bashkive kanë përfunduar procesin e transferimit të pronave

Në termat e menaxhimit të pyjeve progresi është ende i vogël, pasi NJQV dhe SHPPKK nuk kanë kapacitetet e duhura teknike dhe organizative për menaxhimin e pyjeve komunalë. Komunat dhe SHPPKK nuk kanë kompetencat për të kryer menaxhimin e qëndrueshëm she nuk janë financiarisht të qëndrueshme. Projekti për Zhvillimin e Burimeve Natyrore (PZhBN) po përpiqet të çojë më tej procesin e njohjes dhe regjistrimit të pyjeve në përputhje me ligjin për transferimin e pronave publike. Kjo shpresohet të arrihet nëpërmjet një metodologjie të mirë organizuar për rishikimin dhe përgatitjen e planeve të menaxhimit. Kjo konsiderohet si mjeti thelbësor që përcakton rehabilitimin/rigjenerimin e pyjeve dhe mbrojtjen e tokës nga erozioni.

Situatë e re dhe përvoja e fituar në menaxhimin e pyjeve komunale kërkonte që institucionet shtetërore të marrin masa për përmirësimin e kuadrit ligjor. Në këtë kuadër, u përgatitën dhe u miratuan ligji i ri i pyjeve, ligji për transferimin e pronave publike njësisive të qeverisjes vendore, si dhe një sërë aktesh të tjera nënligjore. Kuadri i ri ligjor intensifikon procesin e decentralizimit në menaxhimin e burimeve natyrore dhe eliminon një sërë kufizimesh të parashikuara në ligjet e mëparshme. Përveç këtyre zhvillimeve pozitive, procesi i transferimit dhe menaxhimit të pyjeve komunale nga komunitetet lokale ka ende shumë mangësi, veçanërisht për sa i përket ndarjes së përgjegjësisë e përfitimeve dhe investimeve në pyjet komunalë. Sfidat kryesore në procesin e MPK janë si më poshtë:

- Përmirësimi i politikave pyjore që lidhen me pylltarinë komunale për sa i përket çështjeve të pronësisë, sigurimit të të ardhurave, etj;
- Kuadri ligjor për transferimin e pyjeve në përdorim/pronësi komunave është ende i pa plotësuar;
- Mungesa e vullnetit të vendim-marrësve për ndarjen e kompetencave dhe përgjegjësisë për qeverisjen e pyjeve sipas dy niveleve: pyje shtetërorë dhe pyje komunalë
- Nuk ka ende një metodologji të miratuar për përcaktimin/shënimin e kufijve të burimeve natyrore sipas fshatrave/komunave;
- Shërbimi Pyjor ende mban në mënyrë të centralizuar menaxhimin e burimeve pyjore si dhe të ardhurave që gjenerohen prej këtyre burimeve

- Shërbimi Pyjor vendos në mënyrë arbitrare për zonat pyjore që do tu transferohen fshatrave/komunave, pa marrë parasysh kufijtë tradicionalë dhe kërkesat e komunitetit .

Tabela e mëposhtme përmbledh çështjet kritike dhe rekomandimet e dhëna në Konferencën Kombëtare të SHKPKK, mbajtur në Qershor 2006

Tabela 4 Çështjet kritike dhe rekomandimet për përmirësimin e politikave dhe legjislacionit për pyjet

ÇËSHTJET KRITIKE	REKOMANDIME/PROPOZIME/SUGJERIME
Mungesa e politikave të qarta e të përshtatshme për pronësinë e tokës dhe menaxhimin e pyjeve komunalë	Përgatitja e paketës për rregullimin e të drejtës së pronësisë në pyjet komunalë, dhe përmirësimi i akteve nënligjore për transferimin dhe menaxhimin e pyjeve komunalë
Një ligj jo i përcaktuar mirë për pyjet komunalë (ligji aktual nuk fokusohet në çështjet kryesore të pylltarisë si pronësia dhe të drejtat e përdorimit, decentralizimi dhe delegimi i kompetencave)	Plotësimi i kuadrit ligjor për transferimin e pyjeve komunalë në pronësi të fshatrave dhe pushtetit vendor dhe menaxhimin i qëndrueshëm i tyre nga komunitetet lokale.
Një ligj jo i përcaktuar mirë për pyjet komunalë (ligji aktual nuk fokusohet në çështjet kryesore të pylltarisë si pronësia dhe të drejtat e përdorimit, decentralizimi dhe delegimi i kompetencave)	Përmirësimi i politikave pyjore për të stimuluar gjenerimin e të ardhurave nga pyjet komunalë përfshirë prodhimet e dyta pyjore, kafshët e egra, gjuetinë, et, dhe sigurimi i instrumenteve ligjorë dhe institucionale për përdorimin e këtyre të ardhurave për përmirësimin e jetesës së komuniteteve;
Mungesa e të drejtave të përdoruesve për të gjeneruar të ardhura nga aktivitetet në pyjet komunalë.	Decentralizimi i vendim-marrjes për tarifatat pyjore në nivelin e pushtetit vendor.
Mungesa e njohurive dhe transferimi i teknologjive	Ngritja e një shërbimi këshillimor efektiv për pyjet komunalë.

6.2 Sfidat e politikave për pyjet privatë

Çështjet e politikave për zhvillimin e pyjeve privatë në Shqipëri janë të shumta, pasi, përveç qëllimeve për menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve privatë, ato përfshijnë objektiva për zhvillimin e agro-pylltarisë në terrenet jo pyjore. Nevoja për hartimin e një politike ndër-sektoriale për zhvillimin e pyjeve privatë i dedikohet edhe karakteristikave të zonave rurale në Shqipëri.

Për të përfituar nga situata në pyjet privatë është e nevojshme që në Shqipëri politika pyjore duhet të adresojë disa çështje për përmirësimin e situatës aktuale në këtë sektor.

- 1) Së pari, Qeveria Shqiptare duhet të njohë pronësinë private para vitit 1945. Si pasojë e ligjit të Sherihatit të Perandorisë Osmane, sipërfaqja e pyjeve private në Shqipëri ishte e vogël dhe nuk i kalonte 5% të sipërfaqes totale të pyjeve 63,000 ha). Aktualisht, si pasojë e kufizimeve ligjit nr. 7699, datë 21 Prill 1993 "Për kompensimin në vlerë ose në natyrë të ish pronarëve të tokës bujqësore, kullotave, livadheve, pyjeve dhe tokave pyjore", sipërfaqja pyjore kthyer ish pronarëve është 19,000 ha. Edhe pse kjo sipërfaqe nuk është e madhe, avantazhet dhe përfitimet e nxjerra nga funksionet jo-prodhuese të pyjeve duhen marrë gjithmonë parasysh

Përkundër pyjeve private, agro-pylltaria po merr një rëndësi të veçantë, veçanërisht për kufizimin e degradimit të tokës. Degradimi i mjedisit në Shqipëri është një fakt i njohur dhe kjo jo vetëm në terrenet pyjore për edhe në tokat bujqësore. Erozioni i tokës është një nga problemet kryesore të mjedisit në Shqipëri. Aktualisht, në Shqipëri 82% e tokës bujqësore

është e mbjellë, ndërsa 123,000 ha janë toka të pandara apo të refuzuara [MBU – Vjetari statistikor 1996, Tiranë 1997]. Këto toka janë lënë jashtë vëmendjes dhe po degradohen gjithnjë e më tepër. Një tjetër aspekt është konsumi i druve të zjarrit për ngrohje e gatim në zonat rurale. Në këto zona jetojnë mbi 400,000 familje të cilat konsumojnë rreth 1.2 milion m³ dru zjarri në vit, shumica e të cilave sigurohet nga prerjet e paligjshme në pyjet shtetërorë. Praktikrat e agro-pylltarisë për mbjelljen e disa llojeve me rritje të shpejtë në tokat marginale apo kombinimi i kulturave bujqësore me lloje pyjore me vlerë të lartë, mund të shërbejë jo vetëm për mbrojtjen e tokës por edhe për uljen e presionit dhe prerjeve të paligjshme në pyje.

- II) Së dyti, Qeveria duhet të adresojë objektivin për mbështetjen e zhvillimit të pylltarisë private si një mjet për të ndikuar në dy aspekte: a) në rritjen e të ardhurave të familjes fermere dhe plotësimin më mirë të nevojave të tyre nga kombinimi i kulturave bujqësore, foragjereve dhe llojeve pyjore, dhe nëpërmjet shfrytëzimit më racional të pjellorisë së tokës, dhe b) ndalimin e degradimit mjedisor, kontrollit të erozionit dhe përfitimeve që vijnë nga funksionet jo prodhuese të menaxhimit të qëndrueshëm të tokës bujqësore.

7 Përmbledhje

7.1 Pylltaria komunale

Duke vrojtuar kursin e zhvillimit të politikave pyjore për mbështetjen e decentralizimit të menaxhimit të pyjeve shtetërorë dhe zbatimit të akteve ligjore e nënligjore për pyjet komunalë, sigurisht mund të thuhet se ka progres. Procesi i transferimit të pyjeve komunalë po drejtohet nga MMPAU dhe po zbatohet nga shërbimi pyjor në rrethe, me pjesëmarrjen edhe pse jo aktive të NJQV. Procesi ka pasur kryesisht mbështetjen teknike e financiare të disa projekteve si PP/BB, APFDP financuar nga USAID, PZHBN, SNV dhe donatorë të tjerë.

Një numër ligjesh bazë si ligji i pyjeve (1992, 2005), ligji për bimët mjekësorë, eterovajore e tanifere (1993), ligji për faunën e egër dhe gjuetinë (1994) dhe aktet në ligjore lidhur me të, rregullorja e Ministrisë së Bujqësisë nr. 308, e Janarit 1996 për gatitur me asistencën e PP/BB, etj, kanë hedhur disa piketa thelbësore për procesin e transferimit të pyjeve komunalë, ndërkohë që projektet pilotë hapën rrugën për zhvillimin e procesit. Ligjet për qeverisjen vendore (2000), për pronat publike dhe transferimin e tyre NJQV (2001), dhe përmirësimet e mëvonshme të ligjeve apo ligje të reja për pyjet gjuetinë, etj, zgjerojnë bazën ligjore për shtrirjen e mëtejshme të procesit të transferimit. Ndërkohë, në çdo komunë të përfshirë në procesin e transferimit janë ngritur SHPPKK, të cilat më vonë krijuan federatat rajonale dhe Shoqatën Kombëtare. Shoqatat kanë meritën për pjesëmarrjen në përgatitjen e planeve të menaxhimit gjatë procesit të transferimit dhe zbatimit të tyre me mbështetjen e fondeve nga PP/BB, duke kontribuar në përmirësimin e gjendjes së pyjeve dhe zbutjen e varfërisë në zonat rurale.

Në fund të vitit 2006, procesi i transferimit ishte realizuar në 138 komuna, duke përfshirë 1290 fshatra me 160,118 familje. Sot, ky proces është pothuajse i përfunduar në të gjitha komunat e Shqipërisë. Mund të thuhet se rezultatet janë të kënaqshme dhe inkurajuese në shumicën e komunave për sa i përket ndryshimeve në bindjet e përdoruesve për vënien nën mbrojtje të pyjeve që edhe më parë konsideroheshin si pronë e tyre. Për herë të parë përdoruesit u bashkuan në shoqata që mundësojnë sigurimin e fondeve për investimet në pyjet komunalë, për edhe për forcimin e solidaritetit midis tyre. Në shumë rrethe, mund të vërehet përmirësimi i pyjeve që gjelbërojnë mjedisin në vend të atyre të degraduara, që sigurojnë lëndë drusore, dru zjarri gjeth për bagëtinë, përveç mbrojtjes së tokës. PZHBN përfshin një sërë komunash të tjera në procesin e transferimit, në përgatitjen e planeve të menaxhimit dhe planeve për mikro-basenet, si dhe zbatimin e këtyre planeve nëpërmjet ndihmës së shoqatave.

Eksperiencia tregon se menaxhimi i pyjeve nga banorët lokalë është i suksesshëm për disa arsye:

- Arsye ekonomike – shpenzimet për qeverisjen nga fshati janë më të vogla se ato të shtetit dhe mundësitë për mbrojtje janë më të mëdha sepse fshatarët janë të interesuar ti mbrojnë ato.
- Arsye sociale – fshatarët kanë qenë tradicionalisht zotërues të pyjeve pranë fshatrave që tashmë u janë transferuar formalisht në përdorim/pronësi, ndërkohë që gjatë periudhës së ekonomisë së centralizuar, shesh këto pyje priteshin për shtylla miniere apo për furrat e bukës së kooperativave bujqësore pa i pyetur ata.
- Arsye mjedisore – kur fshatarët janë të bindur se pylli u përket atyre dhe kjo është e konfirmuar edhe me dokumente, ata bëhen më të ndjeshëm për mbrojtjen e pyjeve dhe burimeve të tjera natyrore, duke pasur edhe përfitime direkt.

Duhet theksuar se popullsia rurale përbën rreth 54% të popullsisë së përgjithshme dhe 71% e popullsisë rurale është e punësuar në aktivitete bujqësore, përfshirë pyjet.

Me gjithë këto arritje, ideja e shumë aktorëve është se procesi i transferimit po ecën me ngadalë dhe për më tepër nuk është përfunduar plotësisht në asnjë nga komunat, sepse familjet fermere nuk kanë marrë asnjë dokument që provon të drejtat e tyre ekskluzive mbi pyllin e marrë në përdorim. Kjo ka ndodhur për një sërë arsyesh, por më të rëndësishmet janë::

- Politika të paqarta lidhur me sigurimin e të ardhurave dhe menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve nga komunitetet lokale
- Boshllëqe në aktet ligjore për pyjet komunalë dhe se ato nuk zbatohen si duhet
- Kapacitete të pamjaftueshme në NJQV për të asimiluar procesin
- Njohuri të pamjaftueshme mbi procesin nga përdoruesit dhe mosbesimi i tyre ndaj veprimeve të qeverisë, etj

7.2 Pylltaria private

Sipas të dhënave të vitit 1945, pyjet privatë në Shqipëri zinin 63,000 ha nga 1,379,000 ha që ishte sipërfaqja e përgjithshme e pyjeve. Pas 1945, filloi procesi i shtetëzimit masiv të pronës private dhe disa vjet më vonë koncepti i pronës private u harrua. Njohja dhe rikthimi i pyjeve privatë ish pronarëve filloi pas viti 1996. Kështu, vetëm 6,300 ha ose 10% e pyjeve private u ishte kthyer ish pronarëve deri në vitin 2000, ndërsa në fund të vitit 2007 sipërfaqja e kthyer arrin në 19,000. Procesin e rikthimit është shumë i ngadaltë dhe ish pronarët po përballen me probleme të ndryshme.

Prona private në pyje është bërë tashmë një realitet edhe pse jo shumë entuziast. Zhvillimi i ekonomisë së tregut hapi horizonte të reja për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme në sektorin e pyjeve private. Dhënia me qira e tokës pyjore për kultivimin e bimëve mjekësore-eterovajore, përmirësimi i pyjeve të degraduara apo pyllëzimet janë disa nga mundësitë për nxitjen e zhvillimit të pyjeve privatë. Partneriteti i sektorit privat dhe shtetëror krijon mundësi të tjera për të ndaluar degradimin e mëtejshëm të pyjeve dhe përmirësimin e tyre.

Aktualisht, në Shqipëri, politika për menaxhimin e pyjeve privatë nuk është e plotë dhe procedurat për zbatimin e saj nuk ekzistojnë ende. Dispozitat ligjore nuk reflektojnë ndryshimet aktuale në menaxhimin e pyjeve privatë. Ligji i pyjeve dhe Strategjia për Zhvillimin e Sektorit të Pyjeve dhe Kullotave i përmendin tangencialisht pyjet private, pa përcaktuar qëllimet dhe mënyrat për menaxhimin e qëndrueshëm të tyre.

Për të përmirësuar menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve privatë në Shqipëri, politika pyjore duhet përmirësuar për të qenë në një hap me zhvillimet e sektorit privat në pyje. Objektivat politike mund të arrihen nëpërmjet kombinimit të instrumenteve dhe mekanizmave të ndryshëm ligjorë, financiarë, institucionalë etj. Pjesëmarrja e pronarëve si në formulimin dhe në zbatimin e kësaj politike mbetet një nevojë thelbësore.

8 Literatura

1. Albania Country Profile - Draft CP2002-Albania, Johannesburg Summit 2002.
2. Agolli, Sh. (ed). (2003) – History of Agriculture and Agro-industry in Albania (Albanian), KEA Foundation, Tirana.
3. Castellan, G. - Histoire des Balkans (XIV - XX-e siècle). Librairie Arthème Fayard, 1991
4. Këshilli i Ministrave (2001) – Strategjia Kombëtare për zhvillimin social e ekonomik. Tirana
5. DPPK (1999): Strategjia për zhvillimin e sektorit të pyjeve dhe kullotave. Tirana
6. DPPK (2004) – Strategjia për zhvillimin e sektorit të pyjeve dhe kullotave në Shqipëri. Tirana (pa publikuar)
7. DPPK (2004) – Inventari Kombëtar i Pyjeve (IKP) – Raporti Final (pa publikuar)
8. DPPK (2004) – IKP – Studim special “Plani i Përgjithshëm për pyjet dhe kullotat” (pa publikuar)
9. DPPK (2004) – Project Implementation Manual (PIM) for the Natural Resources Development Project (NRDP), Tirana
10. DRN: Analysis of markets and marketing of forest-based products, July 2003
11. Kola, H. (2006) – The needs and rights of local communities for forest products & services and sustainable forest management in Albania. IUFRO 8th International Symposium Proceedings, Istanbul
12. Kraja F. “Tradita në menaxhimin e pyjeve dhe kullotave komunalë në rrethin e Lezhës” pa publikuar. Tirana, 1996
13. Lako, Th. (2000) - A Proposed Set of Policies for the Improvement of the Private Forestry Development in Albania. ADFP/USAID/Chemomics. pa publikuar.
14. Lako, Th., Male, J. and Collaku, H. (2007) - Legal Aspects of Albania's Communal Forests: Context and Challenges. IUFRO 9th International Symposium on Legal Aspects of European Forest Sustainable Development
15. Lemel, H. (2005) Compilation of reports, findings and proposals on land tenure and organizational issues. Unpublished note.
16. Ligji no. 7623 datë 13.10.1992, “Për pyjet dhe policinë e Shërbimit Pyjor
17. MMPAU (2007) – Strategjia ndër sektoriale për mjedisin
18. MBU, 1998: Strategjia e gjelbër për zhvillimin e bujqësisë
19. Muharremi V. “Considerations on the restitution of forest and pastures to ex-oëners in Albania”. pa publikuar. Tirana, 1998
20. Muharemi, V. (2000) - The Development of Policies on Komuna Forests and Pastures Transfer and Management in Albania, ADFP/USAID/Chemomics, Unpublished note.
21. MBU (1999): Strategjia qeveritare për zhvillimin e bujqësisë në Shqipëri. Tirana
22. Netherlands Development Organization (SNV) (2006) – Inception Report – NRDP: Situational Analysis, Tirana.
23. “Kanuni i Lekë Dukagjinit”. Gjonlekaj Publishing Company. New York, 1989



World Bank
PROFOR
Program on Forests



Confederation of European
Forest Owners



Food and Agriculture
Organisation of the United
Nations

**Konkluzionet e konferencës mbi
„Statusin e pyjeve jo shtetërore në Evropën Jug Lindore”
30.06 – 02.07.2008, Shkup, Maqedoni**

Përfaqësuesit e shoqatave të pronarëve të pyjeve dhe agjencive shtetërore nga Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Bullgaria, Kroacia, Hungaria, Maqedonia, Serbia, Mali i Zi, si dhe ekspertë të pyjeve nga Konfederata (KEPP), Organizata për Bujqësinë dhe Ushqimin (FAO), Agjencia Holandeze e Zhvillimit (SNV), Agjencia Suedeze për Zhvillimin Ndërkombëtar (SIDA) morën pjesë në konferencë dhe diskutuan një gamë të gjerë çështjesh lidhur me menaxhimin dhe qeverisjen e pyjeve jo shtetërorë në Evropën Jug Lindore.

Mbi bazën e rezultateve të konferencës pjesëmarrësit konkluduan si më poshtë:

Sektori i pylltarisë private, me pjesën e tij të prodhimit të lëndës drusore, prodhimeve të dyta pyjore dhe shërbimeve të tjera të tregtueshme, si dhe me sigurimin e shërbimeve publike, ka potencialin për të kontribuar më gjerësisht në zhvillimin e qëndrueshëm në vendet e Evropës Jug Lindore. Të ardhurat ekonomike, mundësitë e punësimit, dhe vlerat mjedisore nga menaxhimi i pyjeve privatë janë në interesin e përbashkët të administratës shtetërore dhe pronarëve privatë të pyjeve.

Sidoqoftë, konferenca pranoi përjasje të ndryshme mbi mënyrën se si të arrihet një përmirësim i kontributit nga sektori i pylltarisë private në zhvillimin e qëndrueshëm në vendet e shënuara, veçanërisht porsa i përket shtrirjes së rregullimeve shtetërore të kërkuara.

Një dialog i rregullt, i besueshëm dhe transparent, midis administratës shtetërore dhe përfaqësuesve legjitim të pronarëve privatë të pyjeve, është një para kusht thelbësor për implementimin e potencialit ekonomik, social e mjedisor të pylltarisë private. Konferenca i njohu shoqatat e pronarëve privatë të pyjeve si partnerë të rëndësishëm për arritjen e objektivave dhe synimeve të politikave kombëtare për pyjet. Programet kombëtare për pyjet u pranuan si një kuadër i vlefshëm për zbatimin e strategjive përkatëse.

Për sa i përket menaxhimit të pyjeve jo shtetërorë, pjesëmarrësit rekomandojnë që:

- Të ngrihen kapacitetet dhe të zbatohen përjasje silvikulturore koherente dhe një menaxhim gjithëpërfshirës i burimeve natyrore në pyjet jo shtetërorë;
- Të synohet për qëndrueshmërinë e burimeve natyrore në pyjet jo shtetërorë dhe përfitimeve të tyre për shoqërinë;
- Të rritet llojshmëria e prodhimeve dhe shërbimeve me një shpërndarje strikte e të ardhurave për kostot përkatëse dhe të sigurohen shërbime publike nga pyjet mbi bazën e financimeve publike të përshtatshme;

- Të organizohet bashkëpunimi i pronarëve privatë të pyjeve nëpërmjet shoqatave apo aktiviteteve të tjera të përbashkëta;
- Të marrin pjesë aktivisht dhe rregullisht në procesit vendim-marrëse politike;

Për sa i përket kuadrit ligjor dhe financiar të pyjeve jo shtetërorë, pjesëmarrësit rekomandojnë që:

- Të përfshihen burimet e ndryshme natyrore të pyllit (lëndë drusore, gjueti, kërpudha, etj) në mënyrë gjithëpërfshirëse në të drejtat e pronësisë private me qëllim që të evitohet çdo konflikt i interesave të menaxhimit.;
- Të kufizohen shtrëngimet e të drejtave të pronësisë të pronarëve privatë të pyjeve aq sa është e mundur dhe të përqendrohen kufizimet në ato subjekte ku shfrytëzimi i të drejtave të pronësisë private bie ndesh me interesat publike për zhvillimin e pyjeve (p.sh., masa mbrojtëse, akses publik në zonat pyjore etj);
- Të krijohen mekanizmat e përshtatshëm për financimin e shërbimeve publike të pyjeve (p.sh., taksat e “gjelbër” mbi të ardhurat);
- Të mbështetet pylltaria private nëpërmjet ngritjes së kapaciteteve të shoqatave të pronarëve privatë të pyjeve;
- Të kompensohen humbjet ekonomike shkaktuar nga shtrëngimet ligjore të të drejtave të pronësisë nëpërmjet mjeteve dhe procedurave të përshtatshme (p.sh., përjashtim nga taksat, subvencione të veçanta);
- Të sigurohen mjetet e përshtatshme për zbatimin e të drejtave të pronësisë në pyjet privatë (p.sh., kadastra, inventarizimi i pyjeve);
- Të ngihen kapacitetet për kuptimin publik dhe pranimin individual të përkufizimit ligjor të të drejtës së pronësisë në pyje;
- Të sigurohen masat ligjore për konsolidimin e tokës, p.sh., nëpërmjet mbështetjes së shoqatave të pronarëve privatë të pyjeve, incentivave për tregtimin e tokës pyjore etj;
- Të ndahen në mënyrë organizative funksioni kontrollues i shtetit nga funksionet e menaxhimit;
- Të vazhdohet dhe përshpejtohet procesi i kthimit të pronave sipas rregullave kombëtare;
- Të përfshihen pronarët privatë në mënyrë adekuate në vendim-marrjen për politikat pyjore, veçanërisht për të ndihmuar institucionet shtetërore të njohin dhe të marrin në konsideratë çështjet specifike të pylltarisë në shkalë të vogël.

Pjesëmarrësit nga vende të ndryshme shprehën synimet e tyre për ti përdorur këto konkluzione si një input në proceset kombëtare të politikës pyjore në vendet e tyre dhe për të lobuar zhvillimin, brenda vendit, të një kuadri politik specifik sa më mirë të jetë e mundur.



Status Quo Analysis

**Analyses of communal and private forestry in Albania
and their role in the National Forest Strategy process**

Dr. Thimaq LAKO

Tirana, June 2008

TABLE OF CONTENT

LIST OF ACRONYMS.....	47
LIST OF TABLES.....	47
LIST OF CHARTS.....	47
1 Forest and Forestry Overview.....	48
1.1 The position of forestry within the national economy.....	48
1.2 Ecological conditions of forests.....	49
2 Ownership conditions in forestry and their short recent history.....	52
2.1 Background.....	52
2.2 Policies and legal provision in the past.....	52
2.2.1 The period before Albanian Independence in 1912.....	52
2.2.2 The period before 1945.....	53
2.2.3 The period 1945-1990.....	54
2.2.4 The period after 1990.....	55
3 Organization of private and community forest owners.....	56
3.1 Decentralization of the State Forest Management.....	56
3.2 The Forest and Pasture Users' Association.....	58
3.2.1 Political & Institutional situation.....	58
3.2.2 The transfer of forest rights.....	59
3.2.3 Establishment of forest and pasture users association.....	62
3.3 Organization of private forest owners.....	64
4 Recent policy development on private and community forestry.....	66
4.1 Basic orientations for forestry.....	66
4.2 Forestry Goals.....	66
4.3 Administration of Communal Forests.....	67
5 The relevant policy process in overview.....	70
5.1 Background.....	70
5.2 Policy framework.....	71
5.2.1 5.2.1. Forestry Policy Goals according to SFPSD.....	72
5.2.2 5.2.2. Forestry Policy Goals according to the new forest strategy (2004).....	72
6 Private/Community forestry in the NFP/NFS process.....	74
6.1 Challenges on the decentralization of forest management.....	74
6.2 Challenges on the private forest policies.....	75
7 Summary.....	77
7.1 Community forestry.....	77
7.2 Private forestry.....	78
8 Literature.....	79
Conclusions of the conference on „The status of non-state forestry in South East Europe”...80	

LIST OF ACRONYMS

AFP	Albania Forestry Project
ANFI	Albania National Forest Inventory
APFDP	Albanian Private Forestry Development Program
CEPF	Confederation of European Forest Owners
CFM	Community Forest management
CM	Council of Ministers
DFS	District Forest Service
DFPP	Directorate Forestry and Pasture Policy
DGFP	Directorate General of Forests and Pastures (in the Ministry of)
EU	European Union
FAO UN	Food and Agriculture Organization of United Nations
FPUA	Forests and Pastures Users' Associations
GDP	Gross Domestic Product
kg	kilogramme
LGU	Local Government Unit
MEFWA	Ministry of Environment Forests and Water Administration
MOAF	
MPT	Management Plan Team
NACFPA	National Association of Communal Forest and Pastures of Albania
NGO	Non-governmental Organisation
NRDP	Natural Resource Development Project
PFO	Private Forest Owners
SEE	South East Europe
SFM	Sustainable Forest management
SFPSD)	Strategy for the forest and pasture sector development"
SNV	Netherlands' Development Agency
SME	Small and Medium Enterprise
USAID	United States Aid

LIST OF TABLES

Table 5	Forest areas by altitude categories
Table 6	Forest areas by slope categories
Table 7	Forest area according to ownership, for the years 1934 and the period 1940-1945
Table 8	The critical issues and recommendations for the improvement of forest policies and legislation

LIST OF CHARTS

Fig. 3	Map of the progress of communal forest transfer process in Albania
Figure 4	Forest and Pastures User Associations and their relation with LGU and Forest Service

1 Forest and Forestry Overview

1.1 The position of forestry within the national economy

Forests cover more than 50% of the country's area. Agriculture, including the forest and pasture, is a priority, as declared by the Programme of the Albanian Government for the period 2005-2009. The policy of forestry, according to the National Plan for the Implementation of the Stabilization and Association Agreement (2007 – 2012), aims at the sustainable and multi-functional development of the forestry and pastures. The plan will preserve and protect bio-diversity, productivity, renovation ability, and potential to fulfill the ecologic, economic and social functions at the local, national, and global level, without causing damage to the other ecosystems. This policy supports the extension of new forestry areas, the rehabilitation of burnt and degraded surfaces, the construction and maintenance of water systems in pastures, erosion control by constructing water works, the improvement of timber and non-timber forestry products management, which will result in income generation. [*The National Plan for the Implementation of the Stabilisation and Association Agreement 2007 – 2012, p.194*]

Agriculture and forestry are two important components of land use development in rural areas and closely linked with each other during history. In Albania the villagers manage both agriculture and forestry; typically in diverse agro-forestry systems. Within the agro-forestry systems, agricultural crops, trees and livestock are managed on the same land. Within a watershed, villagers usually use the upper side for forestry (wood and protection from erosion,) and pasture, and the lower side is for agricultural crops.

By the end of 2001, about 58 % of the country's population lived in rural areas (*INSTAT, 2003*). There are disproportions among the distribution of rural population and the distribution of natural resources, which has great impacts on resource use. On the rural plain area where 65.4% of the rural population lives, there is only 40% of the forest area, 39% of pastures and 73% of the agricultural land; while on the mountainous area where 34.5% of population lives, there are 60% of the forests and 61% of the pastures, and 27% of the agricultural land (*An Agriculture Strategy for Albania, World Bank Report, 1992*).

Agricultural and forestry were major branches of the national economy in Albania. In 1992 this sector used to contribute 42.5% of the Gross Domestic Product (GDP). Recent developments have changed the composition of the GDP, where agricultural provides 20.7 % of the GDP (2005). The decline in agriculture's share in the GDP does not mean that agriculture production declined; on the contrary, production rises by 4% each year. The forestry production is not shown as a separate item, but it is well known that agriculture and forestry support approximately half the population, mainly in small subsistence farms

In mountainous zones the forest serves as a source of fuel wood (collected by villagers), but also in urban areas wood is used for heating and cooking. The production of forage and grazing for the livestock is also important.

In some areas, the forestry is the only employment possibility and so one of the main factors for the reduction of poverty and migration. Along with fuel wood and timber, forest areas are used for grazing the livestock and providing fodder. This contributes significantly to the rural families' income [*Effects of the Albania Forestry Project on Poverty Reduction, 2002*]. Though it is an important potential for providing income for the rural population, overgrazing has had a negative effect on the sustainability of natural resources in some areas, and, if it continues, a further decrease in income is expected for the population of these areas.

Recently, The Albania Forestry Project (AFP) and Natural Resource Development Project (NRDP) funded by the Albanian Government and World Bank (AFP WB) has reduced poverty in some areas. A Study (*Effects of the AFP on poverty reduction, 2002*), states that income from forestry (fuel wood, timber, grazing and fodder) accounts for about 20% on the total annual incomes of rural families. In addition, the family income has increased by 30% for the period of 1997-2001, from which the increase of income from the forestry is about 43%. Furthermore, many villagers believe on a substantial increase from the above-mentioned activities in the future. It must be emphasized that the role of forestry on poverty alleviation is not fully recognized at national level.

However, some statistics show that annual income of the forestry accounts for 0.83-1.5 Million €⁶ per year, the income from wood material is 50-75% of that, and medicinal plants and other non-timber forest products are 12-30% [ANFI Project - *Special Study on Forest and Pasture General Plan, 2004*]. The amount of income for 2002 was around 1.44 Million €. Government expenses for one hectare of forest during the last four years have been on average 17 € per year [DGFP, 2003, cit. ANFI Project - *Special Study on Forest and Pasture General Plan*].

This data, without other detailed analyses, does not reflect the role that forestry really plays. It is necessary to take into consideration not only the products from forest sector, but also their other non-market benefits and environmental services as a premise for their sustainable management in the future

1.2 Ecological conditions of forests

Forests are distributed over most of the country, especially on hilly and mountainous areas. The country's relief is mainly hilly-mountainous, mainly of magmatic and sedimentary formations; with steep slopes, partly unstable, with the mean height of 708m above sea level (which is over two times higher than the mean level of Europe). As a Mediterranean country, Albania is included in the Mediterranean Climatic Zone, with relatively short, and very humid winter, and long, hot and very dry summer.

There are 2,731 hours of sunlight accounts for per year at Xarre-Sarande, 2,560 hours in Tirana and 2,046 hours in Kukës. The mean temperature is 16.7 degrees Celsius. The mean annual precipitation is 1,485 mm. About 70% of the annual precipitation falls during the cold season of the year, often in torrential ones.

Mountain soils where the majority of forests is located, are generally shallow. Some medium and medium to thick soils can also be found. , Soil productivity cannot be estimated for the soils which are 20-30 cm deep on limestone karst. It is important if there is good soil between the crevasse of blocks of limestone rocks, where deep soil is created and forest vegetation can grow. In general, soils are very vulnerable to surface and gully erosion, if the natural vegetative cover is destroyed and the shallow soil layer is exposed to the dryness of summer months and torrential rainfall during the winter.

Albania is a country with abundant forests. All forests (public and private), the so-called Forest Fund of Albania, are grouped into 36 administrative units districts. There are 1,498,957 ha of forest area in Albania (Forests, Shrubs, and Open Forests and/or Shrub land - Albania National Forest Inventory 2004)

It is divided as follows:

⁶ Exchange Rate: 1 € = 120 Leke

Forest ⁷		1,498,957 ha
High Forest		294,957 ha (19.68%)
From which:	-Coniferous	84,461 ha
	-Broadleaves	210,496 ha
Coppice forest		405,016 ha (27.02%)
Shrubs		241,724 ha (16.13%)
Open Forest ⁸		557,260 ha (37.17%).

ANFI has given some valuable data regarding natural conditions where forests are distributed. Altitude is an important characteristic. As shown in table 1, less than 14% of all forest sample plots were in the first two classes up to 400 m altitude; more than 40% showed an elevation of more than 1000 m (Table 2).

Table 9 Forest areas by altitude categories

No.	Category	Share of Forest area
1	0-200	4.47
2	201-400	9.32
3	401-600	15.06
4	601-800	13.51
5	801-1000	15.83
6	1001-1200	15.22
7	1201-1400	13.29
8	1401-1600	8.94
9	1601-1800	3.81
10	1801-2000	0.55
11	>2000	...

Source of data: Albania National Forest Inventory (ANFI) Project – Final Report

More than 62% of the forest sample plots were in a terrain with a slope larger than 40% (Table 3), exemplifying the problem forest management faces within Albania, especially for forest harvesting.

Table 10 Forest areas by slope categories

Forest area	
Slope category	Percent
0-10%	2.61
11-40%	35.24
41-70%	49.75
>70%	12.40

Source of data: Albania National Forest Inventory (ANFI) Project – Final Report

In spite of these limiting factors, the conditions are favorable for growing forests, but the forest productivity (of 1.4 m³ wood per hectare per year on average) is much lower than in other European countries. Changes in the landscape through opening land for agriculture and through heavy grazing, increasing along with the increase of population, fires, grazing and cutting fuel wood and timber pressure are important degradation factors in Albania.

⁷ Forest is defined as an area covered at least 30% by dense trees on more than one tenth of a hectare [Law no. 9385 “On Forests and Forest Service”]

⁸ Open forest or forest land is defined as an area covered by 5-30% by forest vegetation, unregistered in another land use cadastre. [Law no. 9385 “On Forests and Forest Service”]

Albania is home to approximately 415 wood processing factories, which process an estimated 360,000 m³ of wood every year. The annual consumption of fuel-wood per rural household was estimated at 4.3 m³ per year. The documented level of consumption per rural household is 1.6 million m³ of fuel-wood per year. [DRN: Analysis of markets and marketing of forest-based products, July 2003]

Albania is also well known for the quality of non-wood forest products, such as medicinal plants, ether oil plants, tannin plants, etc. More than 7,400 tons valued at US\$ 10 million are exported on average each year. [ANFI Project - *Special Study on Forest and Pasture General Plan, 2004*]

Over the last 60 years (communist and transition period) Albanian forestry has suffered significant changes. It has reduced its forest area by more than 300,000 ha and most forests have been degraded through over harvesting and over grazing [MOAF, *Green Strategy for agriculture development, 1998*]. Forests degradation and erosion are the main problems in natural resource management.

2 Ownership conditions in forestry and their short recent history

2.1 Background

Private ownership of arable land, fruit-trees, olive-trees, forests, pastures and meadow lands in Albania has been recognized since the early 1900's. Village and clan common property and state property also existed. There were strong laws and traditions for property protection, which were applied by society as an informal law. In particular, the "Mountainous Kanun" and the Forest and Pasture Law of 1923 provided severe punishment for violation of property laws. However, in 1945, the communist regime began the nationalization of forests and between 1950 and 1960 all forests became state property.

Private property, including forests, was legally recognized after the economic and social changes of the 1990's. According to current laws former private forests can be restituted. However the restitution process has been extremely slow, because of procedural problems and a general lack of knowledge about the law.

This situation, combined with the idea created in the minds of many people during the communist regime that "*state property is the property of nobody*", has led to the severe degradation of many forests, mainly those close to villages.

During the transition period, the main objective of the forestry policy in terms of the development of private forestry was the restitution of private forests on the basis of ownership in 1945.

The recognition of ownership and the restitution of the property seized during 1945-1990 is stipulated in the Constitution of the Republic of Albania, approved on October 21, 1998 (Articles 41 and 181). Article 181 defines the goal of the Parliament to amend and complete within 2-3 years the legal provisions to regulate issues related to seizures and confiscations, done before the approval of the Constitution. The DGFP strategies for the Development of the Forest/Pasture land in Albania (1999, 2004), have accepted "The recognition of private property rights and the privatization of public property" (page 45).

2.2 Policies and legal provision in the past

2.2.1 The period before Albanian Independence in 1912

The first period, before Albania's independence until 1912, refers to a very difficult situation where different powers dominated life in Albania with their laws interwoven with ancient traditions. Some of the earliest information on the existence of private forests managed by villages is found in the "History of the Balkans". Under the Byzantine Empire in the VIIth century, a free peasantry began to develop. Its status was expressed in the agrarian law (*Nomos Georgikos*) of Justinian the Second (705-711). The peasants were considered as owners having the right to inherit their wealth, which included arable land, vineyards and orchards. Villagers formed a community which owned the forest, pastures and wild lands. Under the Byzantine Empire, this community was recognized as an administrative and fiscal unit. In later periods, the legal status vested in peasant communities during the Byzantine Empire, was never revoked.

The main document of this time, laying down the first rules for the management of private forests, is the *Mountainous Code (Kanun of Leke Dukagjini)*. The forest law of the Ottoman Empire, enacted in 1870, considered the whole forest area as state property, but this law had a minimal impact in Albania, especially in the autonomous regions of Northern Albania. Therefore, the private forest management

practices until Albania's Independence were primarily based on the "Code of Lekë Dukagjini" [*The Code of Lekë Dukagjini, 1989*].

The code of Leke Dukagjini states that "Any house that produces smoke [i.e., that is inhabited] must have its own landed property" (chap. 12, par. 213); "The property of the house includes the courtyard and garden, vineyards and fields, meadows and woodlands, roads and paths, and boundaries in the mountains, in the lowlands, and in the plains" (par. 214). Paragraph 216 mentions: "The fields, vineyards, garden and meadows, woodlands, small forests and thickets are divided by boundaries".

The Code states, "Common property is the area held in common by a village or a "Banner" for pasture, timber, firewood, hunting, and for other needs". "Common property is not divided, but every inhabited house in the village has the right to the common property of the village, and every inhabited house in the Banner has the right to the common property of the Banner" (par. 232, 233). The land boundaries, both private and common property, were strictly respected by all. "Once boundaries are fixed, they are never moved again" (chap. 13, par. 242), and "In the view of the Code, the bones of the dead and the boundary stone are equal. To move a boundary is like moving the bones of the dead" (par 243). There were severe punishments for violating these rules. For example, "If a strange flock enters another pasture a hundred times in one day, the owner of the flock must pay that many animals as a fine" (par. 287). Regarding damages caused by goats, the Code states, "One goat withers a pasture" (par.745).

During the time of the Code, the forest and pasture areas satisfied the needs of villagers and there were few if any problems with natural resource degradation.

2.2.2 The period before 1945

